

Poeti, publicisti e gazetari Preç Zogaj “bashkëjeton” me letrat në një akt pothuaj sakrifice, duke u tërhequr shpirtërisht në një botë ku hyjnorja dhe njeriu politik nuk krijojnë përplasje.

PREÇ ZOGAJ: SHKRUAJ NGA MUNGESA E KURAJOS PËR TË QENË ANONIM

(Fq. 2)



OPINION

MBI KRITIKËN LETRARE DHE DEMONËT E SAJ


Nga Mehmet Kraja

(fq. 11)

DOSJA "SKËNDERBEU" RRËFIMI I RRALLË I ZHANI CIKOS, VIOLINISTI I RI QË DËSHMON KALVARIN E NJË PREJ VEPRAVE MË TË RËNDËSISHME OPERISTIKE



(Fq. 12)



(Fq. 5)

PARID TEFERIÇI dhe MARK MARKU NJË BISEDË MBI PËRKTHIMIN E ROMANIT TË NOBELISTIT KAZUO ISHIGURO

CEREMONIA

**Ministria e Kulturës ndan
“Çmimet Kombëtare
të Letërsisë 2017”**

(Fq. 5)

KRITIKË

**Nga ndjenja te mendimi
dhe anasjelltas**

Nga Edison Çeraj

(Fq. 10)

“KËNGËT E KRISHTLINDJES”

PËRKTHYER NGA TRE KLERIKË:

**MJEDA,
PRENUSHI
AT MËSHKALLA**

(Fq. 8)



Shkrimtari i njohur bullgar **GEORGI GOSPODINOV:** ROLI I LETËRSISË KUNDREJT EKONOMISË DHE KRIZËS SË SOTME FINANCIARE

Nga fjala në Panairin e Librit të Lajpcigut

(Fq. 14)



EDITORIAL

LIBRARITË JANË KTHYER NË PENGESË PËR SHKRIMTARËT SHQIPTARË. PO PËRSE?

Nga BUJAR HUDHRI

Duket si një paradoks, por për fat të keq ky është sot realiteti i përditshëm në libraritë në mbarë vendin.

Më e theksuar bëhet kjo situatë, sidomos pas përfundimit të Panairit të Librit të Tiranës. Pas gati një jave, e cila mund të quhet vërtet një festë e librit, e cila mbledh në një mjedis të vetëm lexues, autorë, përkthyes, botues dhe media. Me mijëra kopje të shitura librash, radhë të gjata për të marrë autografe nga autorët e preferuar, promovime, intervista, ndarje çmimesh.

Pra, autori shqiptar është në qendër të vëmendjes dhe çdo vit që pason, kjo ndjehet edhe me shumë. Jo vetëm me autorë të konsoliduar tashmë, por edhe ata që e kanë librin e tyre të parë. Do ta quaja këtë pamje të gëzueshme, si një gjendje reale të marrëdhënies së lexuesit me letërsinë shqipe, dhe jo thjesht si një eufori e krijuar nga ditët e panairit. Sepse është e tillë dhe blerja e librave është treguesi më i qartë.

Por tjetër pamje kemi në librari. E gjithë kjo atmosferë e panairit, duket se nuk ka lënë gjurmë. Në marrëdhënien e përditshme të botuesit me libraritë problemi kryesor mbetet libri i autorit shqiptar.

Me përjashtim vetëm të dy librarive të kryeqytetit, “Adrion” dhe “Albania”, që janë edhe libraritë më të mëdha e me staf të përgatitur, është pothuaj e pamundur që t’i bindim librarët e tjerë për të ekspozuar librat e autorëve shqiptarë. Autorët e rinj, as që bëhet fjalë, por e kam fjalën për dhjetra autorë të tjerë shqiptarë, që tashmë janë të përthyer edhe në gjuhë të tjera, të cilët lexuesi në gjithë hapësirën shqipfolëse i njeh dhe i pëlqen.

Mendoj që kjo është një histori gati tridhjetëvjeçare. Dhe duhet ta pranojmë, që nuk ishte librari, ai, që e bëri këtë ndarje. Aq më tepër, që në ato vite ende ishin librarët e dikurshëm, të cilat lexonin vetë dhe dinin si ta bënin për vete lexuesin.

Pra, ishte lexuesi i pari që i ktheu shpinën librit shqip dhe i etur, pas letërsisë së huaj, nuk u interesua se çfarë librash të rinj sillnin autorët shqiptarë. Kjo sjellje, si një mënyrë e re e tregtimit të librit, përcaktoi edhe ecurinë e librarive.

Po t’i shtojmë këtu edhe veprimtarinë e shumë botuesve, të cilët pa asnjë *censurë* botuan me dhjetra autorë që paguanin vetë librat e tyre. Por nuk përfundonte këtu historia. Ishin pikërisht, këta autorë dhe botuesit e tyre që promovonin me bujë këtë lloj letërsie, që shumë redaksi televizive e shumëfishonin këtë mediokritet. Dhe lexuesi shqiptar, i jepte të drejtë vetes që të mos i blinte këto autorë. Që mbushnin raftet e librarive, të cilat ishin gjithnjë e më të vogla. Sepse shitja e librit, ky biznes i vështirë në një vend si Shqipëria, nuk të jep mundësi të rritesht, të investosh. Kur e ke edhe shtetin krejtësisht të pandjeshëm ndaj kulturës sonë kombëtare.

Dhe librarët bëjnë atë që tregu u ka mësuar më së miri: e çmojnë që në kopertinë librin, shitet apo jo! Është autor i huaj apo shkrimtar shqiptar? Pothuaj fiton gjithmonë i huaji.

Po korrim atë që kemi mbjellë në vite!

Poeti, publicisti e gazetari Preç Zogaj “bashkëjeton” me letrat në një akt pothuaj sakrifice, duke u tërhequr shpirtërisht në një botë ku hyjnorja dhe njeriu politik nuk krijojnë përplasje; në të kundërt, sipas poetit, ngjarjet dhe lëvizjet e vërteta janë te poezia e madhe, si sintezë e shumë realiteteve; së fundi, ka ribotuar përmbledhjen poetike “In love” si dhe ka botuar kolanën e librave për tranzicionin, të shkruar me stil letrar në tre volume, nën titullin “Nga fillimi në fund”.

PREÇ ZOGAJ: NJË LIBËR I RI?! ËSHTË MUNGESA E KURAJËS ME QENË ANONIM

Intervistoi: Violeta Murati

- Çfarë kërkon një poet kur bëhet gati për një akt final, botimin e një libri? Gjithmonë një libër më të ri se vetja?! A është botimi, e ribotimi, “In love” ngjarje e kësaj natyre?

- Për ta nisur nga pyetja e fundit, do të thosha se “In Love” është një përmbledhje e poezive të mia më të mira me temën e dashurisë, të shkruara dhe të botuara përgjatë viteve, qëkurse kam nisur të botoj libra me poezi. Pra, nuk ishte një vëllim me poezi të reja as kur u botua për herë të parë vitin e kaluar. Këtë vit pati një ribotim të këtij libri nga botuesi UET Press me një kopertinë dhe me letër të cilësisë së lartë. “In love” është aq i ri si libër sa ç’mund të jetë tabloja e takimit nën një çati të poezive simotra që kanë qenë të shpërndara në libra në ndryshëm. Tani kthehem te pyetja e parë. Ma merr mendja nuk ka një përgjigje të vetme rreth asaj se çfarë kërkon poeti kur bëhet gati për botimin e një libri. Përgjigja e parë që të vjen në mendje është: Asgjë! Nganjëherë, apo shpeshherë pasi ke botuar librin e parë apo të dytë, të botosh një libër të ri me poezi është një zakon, është edhe mungesa e kurajës me qenë anonim, siç thoshte Alen Boske. Librat poetikë në përgjithësi janë një libër unik, filli lidhës i të cilëve është autori. Edhe vëllimet me poezi të Fernando Pesaos, të nënshkruara me heteronime, janë një libër në fakt. Autori e “copëton” në njësi këtë tërësi, siç “copëton” kalendari kohën. Duke thënë këtë, nuk gabojmë aspak po të pohojmë se një libër i ri është një ngulmim për vetëpërmbushje, për thyerje kufijsh, ndërsa ke bindjen se poezitë më të bukura ende nuk i ke shkruar.

- Keni botuar këtë edicion të panairit edhe kolanën e librave për tranzicionin, të shkruar me stil letrar, në tre volume, nën titullin “Nga fillimi në fund”. Nuk dyshojmë, por mund t’ju pyesim: si publicist, i angazhuar me politikën, pse riktheheni te këto rrëfime? A do të keni botime të tjera të këtij lloji?

- Kam nëntë libra për tranzicionin. Tetë prej tyre i kam shkruar e botuar pak a shumë në kohë reale me ngjarjet politike dhe shoqërore që pasqyrohen në to. Vetëm njërin, atë me titullin “Fillimet”, që duhej të ishte i pari nga pikëpamja kronologjike, e kam shkruar të fundit, një çerek shekulli larg ngjarjeve të periudhës 1990-1992 që ka në fokus. Profesionimi im është gazetar, publicist. Profesionimi dhe vetë pjesëmarrja në politikë, edhe si protagonist në disa momente, me kanë shtyrë ta dokumentoj tranzicionin, duke rrëfyer për ngjarje që i kam parë e jetuar nga afër. Këto lloj librash janë shkruar e shkruhen prej shekujsh. Nuk pretendojnë të jenë libra historikë, por e ushqejnë historiografinë. Ishte ideja e presidentit të Universitetit Europian të Tiranës, zotit Henri Çili, që këto botime të shpërndara në kohë, të botuara dhe të ribotuara si libra dhe “botë” me vete, t’i përmbledhonte në një kolanë me tre volume, nën titullin “Nga fillimi në fund”. Merret vesh se nuk u jam kthyer unë, është një projekt i botuesit në dakordësi me mua, për t’i marrë nën patrimoniancën e UET Press, siç ka bërë me disa autorë dhe libra të tjerë. Besoj se do më duhet të shkruaj edhe dy libra të tjerë për ta kompletuar këtë kolanë. Është një bast me ngjarjet që pritet të ndodhin. Në të kaluarën këto lloj ngjarjesh më ngarkonin dhe më okuponin shumë mendërisht e emocionalisht. Më duhej t’i shkruaja patjetër. Tani është ndryshe. Nganjëherë më vjen të mendoj se ngjarjet dhe lëvizjet e vërteta janë vetëm ato që shënon poezia e madhe, si sinteza e shumë realiteteve.

- Është i njohur postulati se poezia është një operacion gjuhësor i shkallës më të lartë, duke iu përgjigjur gjuhës, siç keni përmendur në termat e bukurisë, sensualitetit, urtësisë, ironisë... Siç thoshte, ndër të tjera, Brodski, se poezia është diçka më shumë se një art, “është një mëtim i yni antropologjik”, çfarë besoni në këtë përmbushje të



“

Poeti është një vizitor, është dyzimi i qenies. Derisa Ndoc Gjetja jetonte, fliste, ecte dhe merrte frymë si poet, e konsideronte të tillë, ndaj njërit prej librave të tij ia kishte vënë titullin “Çaste”, për të thënë me fjalë të tjera atë që thoshte Fan Noli për Bethovenin, se frymëzimet artistike janë vërtet çaste në raport me kohështrirjen e gjatë në pluhurin e jetës së përditshme të krijuesit. Poeti ka ikur e më ka lënë, dhe vazhdon të ikë e të më lërë vazhdimisht këtu, prozaik, bashkëkohor.

”

natyrës njerëzore, kur tashmë njeriu është politik?

- Nga leximet e intervistave të shumta të Brodskit kanë vënë re se ai jetonte shumë me poezinë dhe po aq shumë për enigmën e saj. Sidomos kur u largua nga Bashkimi Sovjetik dhe u vendos në SHBA, ku iu dha mundësia të merrej vetëm me poezinë. Ai ka me dhjetëra e dhjetëra sentenca të mrekullueshme si këto që cituat ju. Krijimtaria e tij autentike dhe vlerësimet e larta që ka për poezinë, ushqejnë cilësisht njëra-tjetrën. Në një anë janë poezitë që formojnë vlerësimet, në anën tjetër janë vlerësimet që synojnë poezinë adekuate. Është një gjë shumë e bukur kur poetët, përveçse poezi, shkruajnë edhe për poezinë. Këto ditë po lexoj një libër autobiografik të poetit nobelist nga Meksika, Oktavio Paz. Tek ai gjen poetin që e tërheq angazhimin në lartësinë e poezisë së pastër, pa e zbritur poezinë në ultësirat e retorikës. Paz është një prej shembujve të shumtë që na tregojnë se njeriu poetik mund ta përmbajë pa dëme kolektarale njeriun politik.

Nëse ndalemi e kërkojmë, mund të gjejmë po aq shembuj të kundërt. Gjithsesi, në imagjinatën dhe mëtimin tonë për të ardhmen, njeriu politik është tranzicioni që kushedi sa shekuj e mijëvjeçarë do të zgjasë, kurse njeriu artistik është destinacioni.

- Preç Zogaj mbetet po aq tërheqës e lirik për lexuesin, si edhe në shfaqjen e tij të parë në vitet tetëdhjetë, kur ishte një shpresë për të menduarit e lirë të poezisë shqipe – nga një grua poete, çfarë shpjegon për ju kjo “kritikë”?

- Këtë e ka thënë Mimoza Ahmeti në një shënim për librin tim “Ushtrimet e melankolisë”. Kam qenë shumë i prekur kur e lexova dhe jam shumë i nderuar sot e gjithë ditën që një poete dhe artiste vizionare si Mimoza e ka parë me këtë sy krijimtarinë time të para viteve nëntëdhjetë.

Nuk ka qenë qëllimi im dhe madje nuk e kam menduar ndonjëherë para se ta thoshte ajo.


Por e kuptoj, sepse një gjë e ngjashme më ka ndodhur edhe mua me autorë shqiptarë apo me autorë të huaj, të cilët më kanë hapur mendjen. Lexuesi i ngjan poetit që pëlqen. Vetë poeti është, në njëfarë mënyre, esenca e poetëve që lexon. Unë erdha në poezi nga rrethi antikonformist i Lezhës, si nxënës dhe si mik i Ndoc Gjetjes dhe Rudolf Markut. Kam folur shpesh për këtë “shkollë”. Nuk dua të përsëris gjëra të sipërfaqshme, pa gjetur kohën e nevojshme për t’u thelluar te profilet e këtyre dy poetëve, dy njerëz të kohëve të tjera, nuk mund të them të një të kaluar të humbur apo të një të ardhmeje që nuk vjen kurrë. Dua të pohoj se secili prej nesh ndiqte edhe një rrugë të vetën, u përgjigjej edhe thirrjeve të veta; thirrjet e mia me të shpeshta e më të forta ishin ato të lirikës së dashurisë në një kontekst shpirtëror që përfshinte antikitetin, poezinë e vendeve të largëta dhe poezinë e vendeve fqinje të çdo kohë, për aq sa mund ta njihnim, folklorin tonë gjithashtu.

- Siç e thoshte si me shaka Tomas Eliot: do të isha i lumtur të botohesha edhe në një kopje, me kusht që të më lexojë Ezra Paund... Cila është jeta letrare që kanë bërë librat tuaj, keni një bilanc midis jush dhe lexuesit, kur dimë tashmë se poezia ka më pak vëmendje?

- Poezia nuk ka shumë lexues. Nuk ka pasur kurrë, kjo është një gjë e ditur. Nëse do të shtyhesha për të bërë një bilanc, do të thosha se librat e mi vazhdojnë të kenë aq blerës sa për t’i mundësuar botuesit botimin pa humbje të librit të radhës. Lexuesit janë diçka më shumë se blerësit, besoj. Poezia është elitare në një kuptim që nuk është fyese për askënd. Dyert për të hyrë në këtë klub janë të hapura për këdo. Kam përshtypjen se poezia e mirë është një mrekulli kaq e madhe sa e përjashton nga preokupimet e veta njohjen, përhapjen, numrin e lexuesve. Këndeje edhe “shakaja” kuptimplote e Eliotit që mund të mos e marrim si shaka.

“

Jam thjesht një prej adhuruesve të Borhesit në këtë planet dhe më jep një ndjesi lumturimi ideja se do të vazhdoj të jem, edhe pse i papranishëm, me adhuruesit e tij të nesërm që nuk kanë lindur akoma. Borhesi është një demiurg i habitatit të poezisë, të cilin e ndërton njëlloj të mrekullueshëm, qoftë kur përdor erudicionin dhe figura të sofistikuar, qoftë kur nuk përdor asnjë figurë letrare dhe është deskriptiv fund e krye.



- **Ndalemi te ribotimi i vëllimit poetik “In love”. Ç’është kjo përmbledhje me poezi: poeti së fundi, nga fillimi... apo diçka “lamtumire”?**

- Një përmbledhje tematike që lindi si ide e botuesit të UET Press gjithashtu, për t’i dhënë lexuesit të poezisë një koleksion me poezi dashurie, duke parë që dashuria është një temë qendrore e krijimtarisë sime poetike. Pra, nuk është as fillim, as lamtumirë, por një fokusim, një lloj konfeksionimi poetik, një si dhuratë për lexuesit e mi dhe për lexuesit e rinj të poezisë së dashurisë.

- **Profesori dhe studiuesi i letërsisë, Gëzim Basha, i ka quajtur ode poezitë tuaja të dashurisë, duke i vlerësuar si tekste unike. A mund të flitet në këtë rast thjesht për një dimension shpirtëror? Çfarë impenjimi vjen pas kësaj?**

- Poezia është një dimension shpirtëror, dimension shpirtëror është kushti i ekzistencës së saj. Çfarë vjen pas saj, nuk besoj se ka lidhje me të. Meqë përmendet Gëzim Basha, më lejoni të përforcoj përgjigjen time të pyetjes së mësipërme me një pasazh nga parathënia e tij e librit “In Love”, ku shkruan se “odet e kësaj përmbledhjeje bëjnë gjithçka për të mbajtur rreth vetes atë komunitet lexuesish të cilët ende besojnë te poezia e vërtetë lirike, te kjo formë e hershme e komunikimit, e cila me kuptimin dhe jehonat e saj vazhdon të ofrojë mbështetjen më të sigurt për shpirtrat njerëzorë”. Jam vërtet i lumtur që një studiues i kualifikuar dhe një intelektual i lirë si Gëzim Basha vijon t’i kushtojë vëmendje dhe të thotë fjalën e tij të matur e me sqimë, nga SHBA ku jeton e punon, për shumë dukuri të jetës letrare, kulturore, politike dhe shoqërore në Shqipëri.

Kë quani bashkëkohës kur ndesheni me poetin përmes vargjeve që kërkon të mbetet në brezin e tij si “poeti doli nga lëkura ime/ më la të jetoj këtu dhe iku...”?

- Poeti është një vizitor, është dyzimi i genies. Derisa Ndoc Gjetja jetonte, fliste, ecte dhe merrte frymë si poet, e konsideronte të tillë, ndaj njërit prej librave të tij ia kishte vënë titullin “Çaste”, për të thënë me fjalë të tjera atë që thoshte Fan Noli për Bethovenin, se frymëzimet artistike janë vërtet çaste në raport me kohështrirjen e gjatë në pluhurin e jetës së përditshme të krijuesit. Poeti ka ikur e më ka lënë, dhe vazhdon të ikë e të më lërë vazhdimisht këtu, prozaik, bashkëkohor. Poeti

nuk është bashkëkohor. Më saktë, është më shumë se bashkëkohor. Të jesh bashkëkohor në kuptimin që i jep një lloj kritike letrare kësaj fjale, është kufizim. Vargu i mirë e humbet shkollën dhe epokën.

- **Vazhdoj të mendoj se ka ende gjurmë të fortë vëllimi “Qielli i gjithkujt”, botuar në ’90-ën. Është përpirë. Botimet e tjera, si “Fund, një fëmijëri tjetër” apo “Ushtrime të melankolisë”, si dhe ky tani, duket se nuk kanë të njëjtin fat. A bini dakord me këtë, qoftë dhe nga përpjekja juaj për të kërkuar e kërkuar gjithnjë te dashuria. Çfarë ka ndryshuar tek ajo?**

Unë vazhdoj t’ju falënderoj që vazhdoni t’i shprehni respektin tuaj konstant librit “Qielli i gjithkujt”. Jam gjithnjë në pritje dhe në kërkim të një caku të ri të poezisë lirike. Nuk mund të shkruaj si në moshën tridhjetëvjeçare, por mendoj nganjëherë: sikur jeta të ndiqte rrotullimin antiorar, siç bëjnë rrymat detare, pra sikur ta kisha nisur nga “Ushtrime të melankolisë” të botuar në vitin 2016, për të zbritur apo për t’u ngjitur te “Qielli i gjithkujt”, botuar në vitin 1990, mund të më bëhej një pyetje e ngjashme.

- **Keni përmendur se adhuroni Borhesin, si një kërkim i të ngjashmëve. Në fakt, Borhesi është përcaktuar si “i fundit i delikatëve”. Nisur nga kjo, gjejmë të përbashkët iluzionin, shpërthimin metafizik të tij. Në këto kontekste, a është romantizmi për ju njëfarë suite?**

Jam thjesht një prej adhuruesve të Borhesit në këtë planet dhe më jep një ndjesi lumturimi ideja se do të vazhdoj të jem, edhe pse i papranishëm, me adhuruesit e tij të nesërm që nuk kanë lindur akoma. Borhesi është një demiurg i habitatit të poezisë, të cilin e ndërton njëlloj të mrekullueshëm, qoftë kur përdor erudicionin dhe figura të sofistikuar, qoftë kur nuk përdor asnjë figurë letrare dhe është deskriptiv fund e krye. Poezia si iluzion dhe realizimi në metafizikë mendoj se janë dy karakteristikat që e bashkojnë atë me poetin e madh polak, Milosh, të cilin gjithashtu e adhuroj pa fund. Dikur jam tunduar të jem një imitues i Borhesit dhe si i tillë s’mund të isha veçse i varfër. Më mirë ta dua dhe të vazhdoj ta lexoj, sesa ta imitoj.

- **Në poezinë në dy kohë “Arrin e përditshmja” ju shkruani: “Të harrosh çfarë dite është/ dhe çfarë**

plagësh ke marrë/ o bir i paregjistruar i Zotit”. Çfarë ndan nga dashuria, si për Zotin, njeriun?

- A janë apo nuk janë të bukura këto vargje? Mendoj se janë të bukura, përderisa i citoni. Poezia lë shijen, të cilën komenti mund ta banalizojë. Por kur flitet për kontekstin, është e qartë se këtu reflektohet një traditë e poezisë që priret të bashkojë njerëzoren me hyjnoren. Çesllav Milosh shkruan në një poezi të vetën se William Blake kishte të drejtë duke bashkuar në një njerëzoren me hyjnoren. Në Shqipëri kam njohur disa poetë që kanë mbërritur te ky koncept pa i njohur këto mjeshtra. Vargu “O bir i paregjistruar i Zotit” mendoj se na identifikon si deistë të vetëbirisuar apo të gjendur pa e ditur në këtë lidhje me hyjnoren që, siç e ka shpjeguar gjerë e gjatë Miloshi në një ese të tijën, e mbron njerëzimin nga rënia në prishjen e pacak.

- **A mendon dhembshuria mendon për më të keqen?**

Mendoj se dhembshuria nuk mendon, por është.

Kërkimi i dashurisë për një poet është si një gjendje që përsoset nga një varg në tjetrin. A mbetet për ty i përjetshëm ky kërkim?

- Mendoj se po, për mua po. Rabindronat Tagora, poeti nobelist i Indisë, thoshte në prag të vdekjes së tani jam përgatitur të filloj. Gjithë jetën e tij, me çmimet më të larta në palmare, e konsideronte përgatitje për të filluar. Por vdekja e ndërpret këtë mëtim të papërmbushjes së poetit, duke e përtërirë ndërkaq pa pushim te poetët e rinj që nuk i kanë munguar e nuk do t’i mungojnë kurrë botës, derisa të ekzistojë dashuria dhe vdekja për të cilat mund të flitet vetëm me metafora.


- **Naim Frashëri, Dita, Tirana Times, Ora, Toena, Mapo Editions e tjerë. Pse një autor nuk gjen prehje me librin e tij, kështu ndodh pothuaj në të gjitha tregimet e shkrimtarëve këtu?**

Nuk e di se ç’ndodh me të tjerët. Është e vërtetë se librat e mi i kam botuar në disa shtëpi botuese. Ka qenë një raport i caktuar me botuesit. Pastaj tri prej shtëpive botuese ku kam botuar dikur, janë mbyllur. U jam mirënjohës të gjithëve. Tani po gjej “stabilitet” me UET Press, shpresoj të vazhdoj kështu. Por nuk e konsideroj ndonjë mëkat të ndryshosh botues.

Botimi në shqip i romanit “Ditë e mbetur” të nobelistit Kazuo Ishiguro, ku reflektohet “ndërgjegjja e re” e njeriut, – një dialog mbi mjeshtërinë e përkthimit dhe receptimin e Ishiguros në shqip, një shkrimtar tipik britanik, me vetëpërmbytjen japoneze, – vë përballë përkthyesin e tij Parid Teferiçi me kritikun Mark Marku.

PARID TEFERIÇI dhe MARK MARKU

NJË BISEDË MBI PËRKTHIMIN E ROMANIT TË NOBELISTIT KAZUO ISHIGURO




MJESHTËRIA E PËRKTHIMIT

Parid Teferiçi: Në shqip është pak e vështirë për të kuptuar profesionin e mazhordomit, për shkak të konotacionit në gjuhën tonë që kanë marrë hyzmeqarët, shërbëtorët... pavarësisht servilizmit dhe nënshtrimit tonë proverbial... Por gjendemi në një shoqëri “të zgjeruar”, pasi rrëfyeni - mazhordom në roman thotë se të gjithë europianëve të kontinentit (përfshirë edhe irlandezët) u mungon një cilësi e domosdoshme për këtë profesion: vetëpërmbytja. Meqë arritëm këtu, tek vetëpërmbytja, duhet të kemi parasysh që autori ka në gen vetëpërmbytjen tipike japoneze, meqenëse është i lindur në Japoni, Nagasaki, dhe më pas në moshën pesë vjeçare ndjek prindërit në Angli, ku jeton edhe më pas me vetëpërmbytjen tipike angleze. Kështu që teksti i romanit të Ishiguros nuk është i zakonshëm. Jemi mësuar që në një roman duhet të kemi gjatë gjithë kohës zbavitje, ngjarje, përshkrime, dialogje, histori të ndryshme

që e kërkojnë me zor empatinë e lexuesit. Ndërsa në romanin “Dita e mbetur” ndjekim persiatjet e njëpasnjëshme të një mazhordomi plak, i cili, përgjatë një udhëtimi pesë, gjashtëditor, sheh në retrospektivë gjithë të kaluarën e vetdhjetavjeçare në profesion. Një udhëtim i sugjeruar nga punëdhënësi i tij, të cilin ai e shfrytëzon për “arsye profesionale”: niset në kërkim të ish-guvernantes që kishte pasur 30 vjet më parë, me të cilën, për hir të verbërisë së obligimeve “profesionale” nuk kishte arritur të kapte sinjalet e ndjenjave njerëzore. Ai që përpjekur ta mbante marrëdhënien e tyre në «shtratin» e profesionalizmit. Ky njeri është kaq i mbyllur dhe i dedikuar ndaj profesionit të trashëguar edhe nga i ati, një tjetër mazhordom klasik britanik ...

Ata që do ta lexojnë librin do ta kapin menjëherë këtë fill të munguar mes të dyve dhe, të kuptojnë natyrën e çuditshme prej anglosaksoni, i cili merret me persiatjet, që ne na duken qesharake, por për një anglez janë shumë të rëndësishme si; mbi


përkufizimin e dinjitetit, madhësisë...Këto janë sa qesharake kur i lexon aq edhe interesante për të kuptuar botën e ngushtë dhe klaustrofobike të këtij njeriu. Në thelb ky është mazhordom i një residence të madhe lukzose, i asaj të Lordit shumë influent britanik Darlington. Gjatë jetës së tij mediokre, brenda kësaj residence, ndodhin edhe zhvillime të tjera, të një rëndësie epokale për Europën - përtej këtyre historive “mesquine” dhe një mikrobote të çuditshme të një njeriu të frustruar nga profesioni dhe nga pozita e tij sociale. Ai ushqen iluzionin se i përket sërës së “misionarëve të përparimit”, duke e kryer punën e kryeshërbëtorit në mënyrë të përsosur. Gjatë zhvillimit të këtyre persiatjeve mbi rolin e një shërbëtori, ndonëse të një niveli të lartë, kemi edhe ngjarjet që zhvillohen në Evropën e viteve '20 dhe '30, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe ngjizjes së Luftës së Dytë Botërore. Pasi Lordi kishte luftuar me gjermanët në Luftën e Parë Botërore, kemi përpjekjet e vazhdueshme me stil tipik britanik duke iu ofruar



kundërshtarit të mundur dorën e shtrirë ndërkohë, francezët krejt ndryshe nga anglezët insistojnë në vënien e kushteve të forta Gjermanisë. Kjo e çoi më pas në atë përshkallëzim nacional-socializmin në Gjermani dhe furinë hitleriane që iu vërsul pjesës tjetër të Evropës. Kemi praninë në rezidencën e lordit Darlington të shumë figurave të shoqërisë së lartë britanike dhe Evropiane të kohës dhe një nga këto infiltrime është figura e ambasadorit gjerman Ribentrop. Në thelb mazhordomi i shërben me zell lordit të tij, pavarësisht se ky i fundit po merret me një përpjekje krejt donkishoteske, me iluzionin e ndërtimit të paqes përmes bisedimeve sipas kodeve kalorsiake dhe fisnike. Mbërritja e një personazhi si senatori amerikan i qartëson Lordit dhe aristokratëve të tjerë: harrojnë të gjitha virtytet e dikurshme kalorsiake, bota e sotme është shumë e shëmtuar për kësi iluzionesh.

Përtej kësaj kundërvënies debatet që zhvillohen mes sërës së lartë të aristokratëve dhe debateve në sallën e shërbëtorëve janë të njëjtat. Në sallën e shërbëtorëve bisedohet mbi të njëjtat tema si në sallën e aristokratëve. Mbas kësaj është një mënyrë të shkruari ku është një regjistër i bazuar tek reminishenca që pasojnë njëra tjetrën. Besoj se rrjedhshmëria e librit më shumë vlerësohet për patosin që krijon, kjo mënyrë rrëfimi ku narrator mazhordomi Stivens duke folur për veten, dëshmon të gjitha difektet, mungesat, fiksime, të gjithë botën e tij në 360 gradë. Dhe mbasi mbaron libri, një kritik britanik, thotë se duket sikur ke humbur një mik, pavarësisht se mazhordomi ka të mirat e të këqijat e veta. Por duket sikur realisht je ndarë me një person që do të doje ta ngushëlloje, ta përqafoje e t'i thojë se ke çuar jetën dëm

Mark Marku: Unë e kam lexuar librin në anglisht. I vetmi detaj i subjektit është: mazhordomi i referohet vazhdimisht një manuali të vlerësimit, që përcaktonte se çfarë e bën një mazhordom të mirë. Pra, një shoqëri që ka manual etik për mazhordomet, mendon se çfarë manualesh ka për letërsinë dhe cilat janë kriteret e saj. Është një shoqëri ndaj së cilës ne jemi shumë larg, në kuptimin e sensibiliteteve, strukturës sociale, të marrëdhënies së njeriut me letërsinë, të letërsisë me artet e tjera, të letërsisë me shoqërinë, të shkrimtarit me shoqërinë etj. Rasti është te vështirësia e leximit të asaj se çfarë është letrare për anglezët. Në fakt, jeta atje është letërsi. Të rëndomtën ata e lënë jashtë, nuk e përfshijnë. Nuancat e holla të jetës angleze mendoj se përbëjnë një lloj letërsie për ata që nuk e jetojnë atë, atje. E dyta, mendoj se ka dy vështirësi: Ishiguro është një shkrimtar anglez, modern, bashkëkohor, por është edhe shkrimtar me ndjesi japoneze; pra është një përzierje. Mbi të gjitha, mendoj se letërsia është edhe ndjeshmëri, mënyra se si shkrimtari reagon ndaj gjërave. Bashkimi i sensit anglez me atë japonez tek Ishiguro krijon sensibilitetin hibrid, me kultura shumë të largëta. Kjo reflektohet jo te mënyra si e shkruan tekstin, ndërsa e shkruan si anglez, nuk ndërlikon, nuk bën lojë me tekstin letrar. Problemi është te nuancat. Gjithë romani është te nuancat; nëse nuk e kupton romanin, praktikisht mu për këtë arsye nuk e kupton atë. Duke luajtur me titullin, “Mbetjet e ditës”, nuk të mbetet asgjë, për shembull nëse e lexon siç e tregoi Paridi, libri në gjykimin tim nuk ka sens. Është gjëja më pak e bezdisshme kur njeriu lexon Ishiguron, për mua është libër më esencial se sa “Never let me go”, që është bërë hit ndërkombëtar. Ky roman thjesht duhet lexuar në një atmosferë të veçantë. Është përvojë shumë e mirë leximi. Mendoj se Paridi ia ka arritur në mënyrë perfekte, siç ia ka arritur romanit “Gruaja e togerit frëng”,



duke krijuar kështu një përvojë të vështirë, por me autorë shumë të mirë. Nuk mund të them se është një libër shumë i lehtë për t'u lexuar. Një lexues klasi nuk i fut frikën kur i thua se është një tekst shumë i nuancuar, i stërholluar, duke menduar se ata që lexojnë vërtet letërsi, këtë lloj letërsie duan. Libri është shumë i lehtë për t'u lexuar, por problemi qëndron te fakti se çfarë marrëdhënieje krijon me këtë lloj leximi, se kush mund ta lexojë... Madje, një kamerier mund ta lexojë si histori të jetës së vet, pra nuk është ky problemi, por çfarë nënkupton nga gjithë ajo ndjeshmëri, nuancë. Paridi i ka ruajtur këto dhe mendoj se ka kaluar një sprovë shumë të vështirë. Ky është një lloj shërbimi për letërsinë shqipe, sepse në momente të caktuara të kulturave, qofshin dhe ato të mëdha, përkthimet shpeshherë luajnë më shumë rol se autorët origjinalë. Kur ka një lloj boshllëku, unë s'jam për atë që s'ka letërsi të re.

Ka letërsi të re, shumë më e mirë se e vjetra, por

ka raste që nuk i përmbush nevojat për lexim. Vetë leximi kthehet në një akt të brendshëm kulturor nga një akt i jashtëm, që të vjen si vlerë e një kulture tjetër, duke e bërë pjesë të kulturës tënde, në thelb bën një akt kulturor, emancipon shoqërinë, mendoj edhe komunitetin e shkrimtarëve e të artistëve. Ne jemi me idenë e një lloj klasicizmi kulturor që na ka bërë të jemi pak si provincë e provincës, provincës së provincës...

TITULLI I LIBRIT “DITË E MBETUR”, FILOZOFIA DHE PËRPLASJA?

Mark Marku: Në italisht, ky titull mund të tingëllojë perfekt, por nga ajo çka mbetet nga dita në shqip, unë e kisha pa “ajo”... Kur ti mësohesh me titujt origjinalë, apo me titujt që janë botuar në vende të ndryshme, derisa mësohesh, titulli nuk të duket normal. Kjo është si puna e emrit; po të na vendosnin emrin kur ne të ishim të rritur, do

na duhej dy-tre vite për t'u mësuar me të. Por na vendosin emrin kur nuk e kemi vetëdijen e tij. Edhe me titujt e përkthyer ndodh pak a shumë kështu. Në shqip e përkthen thelbin kuptimor të gjithë librit, gjë që varet sipas nesh. Unë kam qenë për variantin italian të shqipëruar: *Ç'ka mbetet nga dita*.

Parid Teferiçi: *The remains of the Day* ka një spektër kuptimor shumë të gjerë. Kam diskutuar me Markun edhe për versionin frengjisht që është “Les vestiges du jour”, si të thuash: mbetjet e Napoleonit, apo mbetjet e Lumo Skendos, eshtrat që mbërritën në Shqipëri... Versioni francez iku, edhe pse ishte shumë poetik. Versioni “ç'ka mbetet nga dita”, bëhej pak shumë i zhavorrshëm... Titulli duhej të ishte atletik siç ishte dhe proza e autorit. Dhe erdhi natyrshëm gjetja, që nuk është identike me origjinalin. Duket si jo “besnike” por është shumë më besnike se sa përkthimi literal... dhe kjo më erdhi gjatë përfundimit të kapitullit të fundit kur ai thotë: *të marr më të mirën nga dita ime e mbetur*. Dhe do të rëndohej po të thuhej: çka mbeti nga dita ime. Me Markun kemi diskutuar nëse “mbetja e ditës” e jepte kuptimin e precipitativit që lë në kujtesë një jetë njerëzore. Dita, në thelb, është jeta e këtij njeriu. *Dita e mbetur*, duke respektuar versionin shqip kur themi: gjella e mbetur apo, buka e mbetur... “vera e mbetur” - jep njëherësh edhe verën e pirë edhe atë pak verë që ka mbetur në shishe dhe po kthehet në uthull. Duke tejkaluar këtë ngërç semantic që kisha me punën e titullit, që më ka shoqëruar nga fillimi deri në fund, do dëgjoj vazhdimisht njerëz që do ankohen pse nuk është ruajtur ndonjë version tjetër. Në thelb kam bërë prerje të fortë, por më duket më besnike kjo “tradhëtia” ime. Dita e mbetur, përveç konotacionit të parë ka dhe diçka tjetër, pasi nënkupton një ditë tjetër që të ka mbetur, e nesërmja - e lë edhe këtë në mënyrë evazive, për ta nuhatur këtë iluzion. Dhe në fakt, kështu mbyllet udhëtimi i mazhordomit: të nesërmen ai do të kthehet në vendin e tij të punës dhe zotohet se do të stërvitet për të bërë shaka... ku me humorin anglez thotë: do të stërvitem për t'i bërë punëdhënësit një surprizë të këndshme.

SHKRIMTARI – TEKSTI – LEXUESI

Parid Teferiçi: Ishiguro nuk është ai lloj autori që të jep zgjidhje. Ai të gjitha romanet që ka, i mbyll me problematikë. Nuk kanë përfundim të lumtur dhe as të trishtë. Të gjitha janë në një tis paqartësie e melankolie. Gjithmonë nuk i jep vetes të drejtën të japë përfundim, këshilla apo mënyra sjelljeje. Sa i përket etiketës tipike britanike, për dikë respektimi i deontologjisë së profesionist është jeta e tij, në rastin konkret. Pasi dhe të atit, mazhordom, krejt papritmas i thuhet se ti nuk do të shërbesh më me tabaka. Këtu i përfundoi jeta, i ra krejt papritmas së bashku me tabakanë. Është dinjitet në lartësinë e detyrës. Përtej kësaj, duke iu referuar një mënyre trajtimi të të jetuarit të jetës, si ajo britanike, është edhe ndjenja e paqartë nëse duhet të ndihet fajtor apo jo, meqë i ka shërbyer dikujt, në thelb, duke bashkëpunuar me të ligën. Duket sikur në mënyrën e narracionit të Ishiguros dalin në pah vetë defektet e personazhit. Sikur kërkon shfajësime, justifikime. Unë doja ta lidhja këtë me paafësinë shqiptare; me ata që i shërbyen një regjimi, të cilët nuk kanë kërkuar falje. Kur një mazhordom ka skrupuj, e gërryen vetveten, pse të kërkojë falje?! Kështu pikëpyetjet etike që ngre Ishiguro me prozën, që na duket e thjeshtë, janë shumë më të mëdha sesa ajo që duket në sipërfaqe.

Mark Marku: Po ta lexosh Ishiguron, se çfarë thotë Ishiguro, kam përshtypjen se do ishte një zhgënjim shumë i madh, pasi ai nuk është një autor që kërkon të hedhë disa ide. Për mua, ai është autori i detajit. Për shembull, në romanin “Never let me go”, që është një roman shumë i rëndë, në kuptimin psikologjik, sentimental etj., ai nuk të tregon melankolinë, por të çon deri në fund, duke të treguar detajet e jetës së atyre bartësve të klonuar që trajtoheshin për t'u përdorur... Ai të lë melankolinë, trishtimin dhe mua më rrallë më ka ndodhur që një libër të më lërë ndjenja se çfarë po ndodh, e jo vetë leximin. Kam lexuar pafund gjëra filozofike, si: a mund ta përsërisni veten, si do jetë raporti mes asaj që krijohet dhe përdorimit të tij për diçka që e ka krijuar Zoti apo njeriu etj., të gjitha po t'i fusësh në planin e ideve se çfarë thotë, atëherë mund të them se për të shkuar tek idetë, s'kam nevojë të lexoj një roman. Nuk thotë asgjë, por të nxit. Ishiguro nuk është shkrimtari që bërtet. Në këtë rast, ndjesia që kisha nga leximi është kjo: kam punuar gjithë ditën, por rri diku pranë bregdetit, apo në shtëpinë time... jam vetëm dhe po bluaj gjëra që më kanë mbetur nga dita. Në njëfarë mënyrë, kjo i ndodh çdo njeriu. Gjërat e jetës ai i vë në një udhëtim gjashtëditor. Është një truk që të shtyn në reflektim kur ti mund të mos mendosh fare për gjërat e atij, librit, as për mazhordimin, dhe askënd. Por mendon për veten: çfarë jam unë që punoj gjithë ditën? Si e bëj diçka bëj mirë apo keq? Dhe ajo çfarë ngelet, duke qenë vetëm për vetëm, duke mos pasur ngut të bësh diçka tjetër, është se ti je aty duke menduar për gjërat që të kanë mbetur në kujtesë Ishiguro luan shumë me kujtesën që lidhet me diçka sentimentale.

Të gjitha janë ngjarje që nuk lexohen për të kuptuar gjëra madhështore. Nuk është ai nga ata që duan romanin epokal, të përplasjes, tragjizmit etj. Ai i shpërfill fare këto, dhe për mua ai është artist i pastër. Nuk abuzon me asgjë. Nuk është patetik. Jemi më patetik ne, që flasim për të, sesa ai vetë. Ishiguro rrëfen thjesht. Për mua një libër monoton është shumë i mirë. Rrëfimi letrar ngjan dhe me atë të përditshmin. Ai ka thënë një gjë shumë normale, pa dalë asgjëkund. Duhet të mësohemi me këtë lloj letërsie, është shumë emancipuese për të lexuarit e të shijuarit.



KAZUO ISHIGURO “Ditë e mbetur”, për mungesën e kurajës

Çfarë vlere ka të shqetësohemi kaq shumë për atë që mund ose nuk mund të bënim për të kontrolluar drejtimin që mori jeta jonë? Doemos që, për ata si ju dhe si unë, është e mjaftueshme të paktën të përpiqemi të japim kontributin tonë të vogël në shërbim të diçkaje të vërtetë dhe me vlerë. Dhe nëse disa prej nesh janë të gatshëm për sakrifica të mëdha në jetë për të arritur këto aspirata, kjo në vetvete përbën, pavarësisht rezultatit, arsye për t'u ndier krenarë dhe të kënaqur. Romani “Dita e mbetur” e nobelistit Kazuo Ishiguro është përkthyer në shqip nga Parid Teferiçi. Nën logon e “Botimeve Pegi”, romani sjell një rrëfim të qetë dhe të shtruar mbi mungesën e kurajës për të bërë zgjedhjet, që mund të vënë në rrezik jetën e kontrolluar dhe të planifikuar për ne nga të tjerë. Kritika perëndimore shkruan se kjo vepër është historia e një dashurie të patreguar, për këdo që “i ka fshehur” ndjenjat e veta. Kryevepra e shkrimtarit rrëfen agonitë e një burri që po plaket, që kupton tanimë se e ka lënë dashurinë e tij të madhe të shkojë. Ishiguro ia del të na bëjë të ndiejmë se kemi në duart tona jetë njerëzore. Peter Beech nga “The Guardian” shkruan se kur libri mbaron, sikur ke humbur një mik. Ai shton më shumë se një herë që ka dëgjuar që, në mënyrë që ta bëjë lexuesin të qajë, një shkrimtar duhet t'i mbajë personazhet me sy të tharë. “Gjendemi përballë imazhit vërtet të plotë të një burri që orvatet dëshpërimisht t'i mbajë përbrenda emocionet e veta. “Dita e mbetur” bën gjënë më të mrekullueshme që mund të bëjë një vepër letrare: të ndiesh që ke ndër duar jetën e dikujt. Dhe kur i afrosh fundit, të duket vërtet se po humb një mik; në këtë rast, një mik që kapardiset në mënyrë qesharake, tepër serioz dhe konformist, por një mik sidoqoftë. Do të doje ta përqafoje, vetëm se atij nuk do t'i pëlqente aspak”, - thotë ai në “The Guardian”. Ngjarjet e këtij romani rrëfohen nga mazhordomi Stivens, i cili për më shumë se tridhjetë vjet ka jetuar në Darlington Holl, rezidenca madhështore e lordit Darlington. Stivensi rrëfen një pjesë të jetës së tij, diku nga mesi i viteve '30, një periudhë e ngarkuar për të personalisht, por edhe për historinë e Anglisë dhe të Europës. Punëdhënësi i tij është një personazh publik, tejet i angazhuar edhe politikisht. Stivensi, nga ana tjetër, nuk ka njohuri të thella mbi çështje të ndërlikuara politike. Ai është njeri i përmbajtur, i cili krenohet me sjelljen e tij prej xhentëlmeni të mirëfilltë dhe si të vetmen përparësi ka t'i shërbejë sa më me dinjitet punëdhënësit të tij.

TI ULESH PREJ PARRIZIT

Përktheu: Ndre Mjeda

Ti ulesh prej parrizit,
O Zot e mbret madhnije.
E në tokë vjen m’u bâ nieri
Vetëm prej dashtënije:
Aq i dashtun jë për né
Qí në një shpellë ti vjen me lé!
O Zot i lum,
Un s’e kam ditë se ti
Né të shkretët na don kaq shumë!
Për ty qí rruzullimin
Gjithmbarë e ké krijue,
S’jânë gjetë as shpí as petka,
E zjermit të ka mungue.
Tash âsht dimen, akull, borë,
Me qindrue njashtu â zór.
O djalë i shkretë!
Prei së ftofti ti po dridhe,
Po dridhe e po bertet!
O Biri i të naltit Zot.
Ti pate gjith lumnín,
Por deshtas e ké lanun
E kapë e ké vorfninë.
Pra pse kján e pse gjimon,
Kerkush tý nuk po t’ankon:
Ti do me më msue
Se pa durim nuk mundet
Kerkush m’u shëlbue.
Ne disha gja ti fshân
E kján, o bukuri,
Perse, si duhet, nieri
S’t’a din gjith at dashtëní;
Vesht e mora un i ngrati
Se at mundim t’a nep ty mkati;
O mkat mallkue!
Por ti, o Zot, më fal!
Më fal se jam pendue!
Ti flën përmbi at grazhd,
O i lumi djalë plot hír.
Por zëmërs me mârrë gjum
I del fort pun’e fshtír.
Zëmra e jote pse po lngon!
Natë e ditë shka po mendon?
Un tjetër s’po mendoj
Veçse me deké per njerin.
Me deké qí ta shëlbuj!
Me lé e me deké për mue
Dashtnija të ka shtërnguemun:
E vetë pa të dashtë, o Jezu,
Si mundemi me rrnuemun?
Shpnesa e ẽme, o Virgjin Mrí,
Me dashtë Krishtin se nuk di,
Tý të kjosha true:
Më mso gjithmonë me e dashtun,
Me e dashtë e me e lëvdue!

Shënim: Në dhjetor të vitit 1754 Shën Alfons de Liguori improvizoi në një kishë të Nolës këngën-himn të Krishtlindjes: “Ti zbret nga yjet”. E lehtë për t’u kënduar, e përshtatshme për mundësitë vokale të fëmijëve, të grave e të njerëzve të popullit, kjo nina-nanë u përhap shumë shpejt e u përkthye në gjuhë të ndryshme të botës, duke u bërë së bashku me “Stille Nacht” një tjetër himn i solemnitetit të Lindjes së Krishtit. Ishte kompozitori Xhuzepe Verdi, i cili i frymëzuar prej dëshirës së Shën Alfonsit i dha muzikën tekstit. Kënga u përthye shpejt edhe në gjuhën shqipe nga meshtari dhe poeti Dom Ndre Mjeda me të njëjtën dëshirë për predikimin e Ungjillit.

O NATË E QETË

Përktheu: At Vinçens Prenushi

Flej, o Qielluer,
Zojës në krahnuer.
Flej, mos kjáj,
ndale at’ váj.
Gjumi t’vjen,
por ty s’t’bahet me fjetë,
pse n’do kashta
t’rrin trupi Ty p’shtetë.

Jezus për p’shtim të gjithë neve,
Jezus për p’shtim të gjithë neve.

Ty Zoja Mri,
Ty gjithë dashtëni,
rrin tuj t’ruejtë,
ambël prujtë,

Ditë do t’vinë, o Shëlbues, me u meké;
Ka me të ra mbi një krygje ty me deké !
Jezus për p’shtim të gjithë neve,
Jezus për p’shtim të gjithë neve!

Shënim: Fjalët e këngës “Natë e qetë” janë shkruar në mbrëmjen e Krishtlindjes së vitit 1818 nga meshtari Joseph Mohr (1792-1848), ndihmësfamullitar në Oberndorf të Salcburgut (Austri). Në të njëjtën natë u muzikua nga Franc Xavier Gruber (1787-1863), organist i qytezës së afërme, Arsndorf. Sipas dëshirës së Mohr-it, motivi muzikor që punuar për dy zëra, shoqëruar nga kori dhe kitara. Mohr-i e këndoi vetë këngën dhe e shoqëroi me kitarë, ndërsa Gryber bëri pjesën e basit. Fjalët dhe melodia u përhapen menjëherë, aq sa kënga u bë “Himn i përbotshëm i Krishtlindjes”. Kjo këngë mbërriti edhe ndër shqiptarë, në fillim të ‘900-ës, kur At Vinçens Prenushi, françeskan përktheu “O e qeta natë”, që u këndua për herë të parë në kishën françeskane të Gjuhadorit në kremtimin e Krishtlindjes në vitin 1920.

Dom Ndre Mjeda, At Vinçens Prenushi dhe At Pjetër Mashkalla në dy variante përkthimi “Ti zbret nga yjet” dhe “Natë e qetë”, këngë himn e Krishtlindjes; versionet vijnë prej klerikëve nga gjuha gjermane dhe angleze në dialektin gegë të cilat, prej kohës së përkthimit, gati një shekull, këndohet edhe sot në kishën françeskane

Këngët himn të Krishtlindjes
PËRKTHIMI NGA
TRE KLERIKË:
MJEDA, PRENUSHI
DHE AT MËSHKALLA

O NATË E QETË

Përktheu: At Pjetër Mëshkalla

Nat’ e qetë, Nat’ e shejtë,
Krishti i lum sot ka le;
Shih si qeshet e bukura f’tyr’,
Me sy t’ambel mbar shekullin k’qyrë’
Flej, o i bukuri, flej
Flej, se shpresa je Ti.

Nat’ e qetë, Nat’ e shejtë
Krishti f’mijë i Zoj’s Mari
Që, në prehen sa mir’ po i rri,
Ejt’këndojnë me brohori:
Erdh i lumi Mesi
Erdh i lumi Mesi.

Nat’ e qetë, Nat’ e shejtë,
Me shpejti vijnë barijt
Me shikue k’të bukuri,
Me adhrue njik’të fëmijë
Krishti plot dashuni,
Krishti plot dashuni!

Shënim: Është një version i përkthimit nga gjermanishtja e tekstit “O natë e qetë”, nga jezuiti At Pjetër Mashkalla, i cili ka qëndruar besnik tekstit nga gjermanishtja, kur nisi të këndohej në kishat e etërve jezuitë ku këndohet edhe sot.

Autobiografi/ Nga libri me tregime autobiografike të At Zef Pllumit, i fundit lënë dorëshkrim, botuar pas vdekjes "Saga e fëmijërisë" botimet Françeskane, 2009

SAGA E FËMIJËRISË

Nga At Zef Pllumi

Nuk mund të përcaktoj moshën që kishm: dy ose tri vjeç. Në shtëpi ishem un i vetëm. Nana kishte shkue te kushrijt. Më kapi nevoja me dalë jashtë e u nisa me hi në pyllin që kishim mbas shtëpije, larg 20-30 m. Në fillim të pyllit nën disa shkoza më ra në sy një furrik pulash me tri vezë në te. Un hina ma thellë në pyllen me qarra, por kur bana me kthye te shtëpija i mora në këmishë ato tri kokrra vezë. I lashë afër zjarrit e shkova e mora fulteren, sepse më pëlqenin pa masë vezët e fergueme kur mi jepte nana. Fulteres i qita ujë e se unë n'at kohë nuk e njifshem vojin, por e kishem pa nanën me fulteren që kishte një lang. Zjarrmi ishte pothuaj i shkimun. Mandej theva vezët një nga një, njanen mbas tjetret, por ato shkriheshin n'ujë. Kishem ndigjue nanën që nganjherë kur më fergote vezët thonjte: "duel e prishin" e largote. Kështu tri vezët duelen "të prishuna" e nuk i vuna në zjarr aspak por dola jashtë me gjithë fultere e i hodha përtej murit të arës, të cilin nuk mbërrijshem me e kalue; e i hodha bashkë vezët me gjithë lëvozhgat e bardha. Mbas nja një gjysh ore po kthen nana prej kushrijve e fillon me ba rangët e shtëpisë. Kishte shkue me e pa furrikun por nuk kish gjetë asnjë vezë aty. Nuk më bani za.

Pak ma vonë erdh Ndou, djali i axhës e anmiku im ma i madh, i cili bashkë me baben tem ruente dhenët shterpa, të cilat i ndrynin në një kasolle atje në ograie ndërsa delet plleja i binte baba në vathë, ngjitun me shtëpi ku ishet edhe një kasolle për to.

Nana, e ndjeva se i tha Ndout:

-Kam pasë një furrik këtu mbrapa shtëpije në të cilën ishin dy voe, por tash që ktheva nga kushrijet nuk pash asnjë kokerr aty. Kush do të mi hanë ato voe, ndonji gjarpën a por tjetër kush?

-Kush ishte ne shtëpi? – e pëveti Ndou.

-Vetëm Preka (emri para se të bëhej klerik) i vogël- i tha Nana.

-Preka i vogël asht sherr i madh e nuk len gjat për së mbarit- i tha Ndoi.

-Joo, more s'ka se si; asht tepër i vogël e ka frigë me hi në pyllë!

-Kush ka frigë me hi në pyllë? Ai asht fëmij i tmerrshëm!-tha Ndou.

Mbas pak minutash Ndou thirri:

-Dadë, o dadë, hajde shif ku ka hjedhë lëvozhgat e voeve!

Dada shkoi e i pa. Mandej më kapi për dore e më çoi në vathë.

-Ti e ke marrë voet atje në furrik?

-Jo, jo!

-Kallxo të drejtën, kush i ka marrë?

-Nuk e di, un jo!

Uh! Fazezi i vogël, po qysh tash don me u ba rrenacak i keq? Kallxo të drejtën o të mbyta!

-Nuk i kam marrë un, jo!

Atëherë ajo largoi një krah kallamash kënete nën të cilat ishte një vandak me thupra thanet që kishin fillue më i mledhë për tharkun e thiut që do të thurej, sepse ato ishin thuprat ma të fortat. Nxori nga ai vandak një thuper, më uli brekët e filloi me i ra mbrapanicës seme disa herësh rreth tue më bërtitë.

-Mos rrej, fazezi!

Un bërtita me sa za kishem. Mbrapanica eme u ba tanë vraga të kuqe e më duekt se i ndiej edhe sot dhimbjet. Ndërkaq nana bërtiste:

-Fazezi, mos rrej por trego t'vërtetën!

Fati i em, në atë kohë erdh baba me dhenët plleja. Më pa tue kja në kupë të qiellës, erdh te dada e i tha:

-Hej ti, a e luejtë mendësh që don me mbyte djalin?

-Nuk due me e mbyte por due me e mësue që mos të rrejë kurr në jetë, sepse ky fazezi i vogël qysh tash ka fillue me rrejte.

-Me rrejtë?! Po kur të rritet do të rrejë me doemos, se rrena asht hallat ose vegël pune; ai ke pa ustallarët që me çekiçin, ministrinë, danat e sharren aty në atë strajcë kanë edhe rrenën, përndryshej nuk gjejnë punë. E si mos të rrejë vogëlushi, shif sa e ke marrë thupren tri herë ma të gjatë!...

Baba Gjeto më hoq prej duerve të nanës e filloi me i lëmua vragat e kuqe të thuprës, ndërsa thonte:

-Ma parë shëndoshesh se martohesh-dhe filloi me më puthë në faqe.

Në të vërtetë un, si të gjithë fëmijët e botës, nuk kishem qejf të më puthin kush e sidomos burrat si baba i em, që u rruejshin krye dy javësh, e qymet e mjekes e fazeve të tynë më dukej si të më fërkojshin me lëkurë iriqit, por atë ditë ato të puthuna m'i pat qejfi e sidomos kur baba më bajti në hava e më tha t'i ndimojshem me mjelë delet se mandej do të më falte edhe një kingj të bukur.

“

Në të vërtetë un, si të gjithë fëmijët e botës, nuk kishem qejf të më puthin kush e sidomos burrat si baba i em, që u rruejshin krye dy javësh, e qymet e mjekes e fazeve të tynë më dukej si të më fërkojshin me lëkurë iriqit, por atë ditë ato të puthuna m'i pat qejfi e sidomos kur baba më bajti në hava e më tha t'i ndimojshem me mjelë delet se mandej do të më falte edhe një kingj të bukur.

”



Ai u ul aty mbi një gur e më mbajti afër vedit ndërsa delet kalojshin një nga një papara tij, bashkë me kingjat që lëviznin bishtin tue pritë për me thithë tamlin nga nana e vet. Ndërkaq un limojshem me dorën e vogël e ata vocrrakë përdridheshin.

Dikur erdh para babës një dele që kishte një kingj shumë të bukur, lara-lara, bardh e zi. Em at më tha:

-Njeket kingj a don me ta falë?

-Po, - i thashë.

Edhe un e putha kingjin në krye, ndërsa ai tue lëvizë bishtin me shpejtësi, e ndeshi kryet e vet në timin.

Nana ishte ulë m'anë tjetër të portares së vathit e i tha babës:

-Po i banë dy laramanat bashkë, na qesin shtëpijet!

-Gjithkush don shokun e vet!-tha baba.

Mbas pak të gjitha delet hynë në vathë me kingjat e tyne. Baba nuk e shprazi mjelcen në kazan të tamblit ku i kishte bashkue Ndou, djali i axhes, por ia dha nanës në dorë e i tha:

-Merre ktu at tamlin e deles që ka kingjin me lara e psheshja djalit, pse due që kingji e djali të thithin një cicë!

-O nieri- i u përgjegj nana- se çë bidate të reja po na qet!

Baba më muer ngrykë e më shtini në shtëpi. Kërkoj prej nanës një post e më uli aty afër votrës, ndërsa ai vetë muer një stol e ndej afër meje.

-Bania gadi përsheshët djalit me tamlin e asaj delje që ka kingjin e larmë!

Nana vuni në zjarm tamlin, mandej muer bluden (pjtatë druri) e përsheshi aq sa mund të hajthem un. Kur vloi tamli e shprazi mbi përsheshët në bluden që ishte në police (sergjen) .

Un i hangra ata pshesh me shije të madhe e m'u duk se asnjë tambël nuk ishte aq i mirë sa ai i deles që kishin kingjin e larmë.

-A të pelqei?- më pëveti baba- tash venu e flej se të merr baba e të çon te shtrati. Sonte flejmë bashkë sepse tjera herë ke fjetë me nanën. Mbas gjith atij vaji më kapi gjumi aty pranë zjarrit.

“Tregime të moçme” e Kutelit nderohet me Çmimin e Bibliofilisë “Lumo Skëndo” 2017

Këtë vit, dhënia e këtij çmimi përmbyll me një varg veprimtarish kushtuar figurës dhe personalitetit të kulturës, Mid’hat Frashërit, – apo “Lumo Skëndo”, pseudonimi letrar me të cilin ai u identifikua kulturalisht gjatë gjithë krijimtarisë dhe veprimtarisë së tij letrare e botuese, ashtu edhe patriotike, shkencore e diturore.

Biblioteka Kombëtare çeli veprimtaritë kushtuar veprës së tij duke risjellë në duar të studiuesve dhe lexuesve të sotëm revistën “Diturija” në një botim bibliofilik e anastatik. Kontributit të Lumo Skëndos si themelues i kësaj reviste, “monument kulture” i trashëgimisë sonë të përbashkët, iu kushtuan dy konferenca shkencore të organizuara nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe e Kosovës, si dhe një bibliografi e hartuar posaçërisht për revistën “Diturija” nga specialistët e BKSH-së. Me Çmimin Kombëtar të Bibliofilisë “Lumo Skëndo” për vitin 2017 u vlerësua shtëpia botuese “Kuteli”, me motivimin: për botim e hijshëm e nostalgjik, ilustruar grafikisht nga mjeshtri Gazmend Leka, të përmbledhjes me rrëfenja “Tregime të moçme shqiptare”, një prej veprave më mbresëlënëse e më të dashura të letërsisë shqipe të çdo moshe, trashëgim monumental nga pena e rrëfimitarit mjeshëtor Mitrush Kuteli. Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, znj. Persida Asllani, i dorëzoi çmimin znj. Atalanta Pasko, themeluese e shtëpisë botuese “Kuteli” dhe bijë e shkrimtarit Mitrush Kuteli. Znj. Pasko, pasi falënderoi për “vlerësimin e dhënë me akordimin e këtij çmimi kaq domethënës”, u shpreh se “në këtë botim janë bashkuar disa vlera, ajo grafike dhe e ilustrimit me rrëfimitarinë dhe tregimet, por edhe përkushtimi dhe puna e palodhur e Elzana Agollit dhe shtypshkronjës “Mali Pleshti”, që solli këtë botim cilësor”.

Edicioni i vitit 2017 i përmbledhjes “Tregime të moçme shqiptare” nga shtëpia botuese “Kuteli” është një botim special që përkon edhe me 110-vjetorin e lindjes së shkrimtarit.

Çmimi Kombëtar i Bibliofilisë “Lumo Skëndo” nga viti 2013 i është besuar Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. I akorduar për herë të parë në vitin 2006, është çmimi i vetëm që nxiti dhe mbështet cilësinë estetike të botimeve shqiptare. Ky çmim i shërben vlerësimit dhe stimulimit të botimeve me vlera të spikatura bibliofilike dhe intelektuale, nëpërmjet evokimit të personalitetit të kulturës dhe të mendimit shqiptar Lumo Skëndo (Mid’hat Frashëri), veçanërisht si themelues i bibliofilisë shqiptare. Mbas ceremonisë së Çmimit të Bibliofilisë “Lumo Skëndo” 2017 në Sallën Franceze të Leximit u zhvillua forumi “Poetika shqipe – trashëgimia shqipe”, organizuar me rastin e botimit të librit *Testamenti* të akademikut Sabri Hamiti, botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me pjesëmarrjen e akademikes Floresha Dado dhe studiuesve të njohur Bashkim Kuçuku, Nysret Krasniqi, Dhurata Shehri, Kastriot Gjika etj.

NGA NDJENJA TE MENDIMI DHE ANASJELLTAS

Nga Edison Çeraj

“Bota është një komedi për ata që mendojnë dhe një tragjedi për ata që ndiejnë”, thoshte Horace Walpole – domethënë: bota na qenka një dramë, duke qenë se nuk ka njeri në botë që vetëm mendon apo vetëm ndien, por herë i jepet njëres gjendje e herë tjetres. Në thelb kjo ndodh pa vullnetin tonë: thjeshtë jepemi pas njëres ose pas tjetres. Ashtu siç nuk zgjedhim se çfarë kujtojmë e çfarë harrojmë, po ashtu nuk zgjedhim se kur do mendojmë e kur do ndiejmë. E gjitha rrjedh. Vetëm rrjedh. Ne dorëzohemi. Pastaj ngrihemi. Më pas zgjedhim. Pastaj harrohem. Më pas kujtohem, me shpresën që të mos jetë vonë. Edhe kur është vonë, ka gjithmonë një xhep kohë për të bërë “atë që duhet”. Është ai xhep kohë që të rikthen të gjithë kohën e humbur.

Duke qenë se komedia është “e kundërta” e tragjedisë, atëherë drama, si një e mesme jomatematikore, është më afër thelbit të botës. Duket sikur bota përmban me tepri komedi dhe tragjedi njëherësh. Pastaj është edhe tragjikomedia, ku një prej shfaqjeve të saj më të “rënda” kohëve të fundit është filmi *La vita è bella* nga Roberto Benigni, me një optimizëm therës që në titull.

Gjithnjë në këtë kontekst, përballemi çdo ditë me optimizmin e pakompromis të progresistëve dhe me pesimizmin e mistikëve. Të parët e mbajnë shikimin poshtë, të dytët lart. Të parët duan të arratisen nga e shkuara, madje edhe nga e tashmja, të dytët gjakojnë të arratisen nga një e ardhme që konceptohet si një “jetë pa dhimbje”.

Disa shpallin fundin e botës, disa të tjerë trumbetojnë “rendin e ri”.

Ngjan sikur ngushëllimi më i madh është se asgjë nuk është e sigurt, se asgjë nuk mund të pohohet apo të mohohet me siguri të plotë. Kjo lloj pasigurie, që përputhet me natyrën e pamundur dhe të papërsosur të qenies-në-botë, ka të mirat e veta, sepse na mban zgjuar, si një antidot kundër shkujdesjes apo kllapisë. Një e mirë tjetër është se na bën më kërkuar, duke u maturuar kështu kundrejt çdo rrethana që na prek drejtpërdrejtë apo tërthorazi. Po ashtu, ndonëse në pamje të parë pasiguria shfaqet si e kundërta e bindjes, në fakt, ajo mund ta forcojë një bindje të caktuar përmes “krizës” që të shkakton, ose mund të nxjerrë në pah pavërtetësinë e saj.

Zakonisht filozofët perceptohen si ata që mendojnë ndërsa poetët janë gjithnjë ata që jetojnë në mbretërinë ndjenjave. Por, natyrisht që nuk mund të jetë kaq e prerë, ose kaq “e thjeshtë”. Pothuajse në çdo libër filozofie hasim çaste poetike, sikundërse te shumë e shumë poezi gjejmë sentenca filozofike, ku mbi shumë syresh mund të shkruash një ese ose një libër të tërë, gjë që ka ndodhur në shumë raste.

Nëse një tekst filozofik ka prirjen të na mbërthejë pas realitetit, një vëllim me poezi prirët të na çlirojë prej tij. E vërteta është se kemi nevojë për të dyja gjendjet. Nëse jepemi vetëm pas njëres, do ta gjejmë veten ose tepër aktivë (filozofia), ose tepër soditës (poesia). Në njëfarë mënyre, filozofia përfaqëson atë që njihet si *vita activa*, ndërsa poesia është rikthim te *vita contemplativa*.

Kur jemi aktivë, harrojmë; ndërsa kur jemi soditës, kujtojmë. Por, e vërteta është se na duhen të dyja, qoftë harresa e disa gjërave, qoftë kujtesa për disa të tjera.

Nevoja organike se si të jetojmë sendërton një marrëdhënie të mirë me harresën; kurse nevoja e ontologjike se pse jetojmë bën po të njëjtën gjë me kujtesën. Por, kjo është e mundur vetëm nëse mes këtyre dy nevojave themelore – që shfaqen në mijëra forma – ekziston një lloj harmonie, sepse në të kundërt ka vetëm teprim me harresën ose me kujtesën.

Jo vetëm në letërsi, por edhe në jetë qëllon të përballemi me personazhe “të lumtur” për shkak të harresës ose “të pikëlluar” për shkak të kujtesës.

Në analizë të fundit, njeriu mbetet ajo çfarë ndien dhe mendon, pasi realizimi/përmbushja praktike e një ndjenje apo mendim është gjithnjë e mangët si pasojë e kufizimit në kohë dhe hapësirë.



MBI KRITIKËN LETRARE DHE DEMONËT E SAJ

Nga Mehmet Kraja



Për shumë kohë, te ne kritika letrare është kundruar si gjini letrare në shërbim. Pra, një gjini letrare që nuk funksionon për veten e saj, por u kryen një shërbim gjinive të tjera letrare, si prozës, poezisë, dramës etj. Në të vërtetë, kritika nuk është gjini letrare e mëvetësishme, nuk është krijimtari themelore, por është një të menduar për letërsinë, një këndvështrim për letërsinë, një gjykim për të. Pra, nëse shprehemi me kategori sociologjike, ajo është superstrukturë; nëse shprehemi me kategori filozofike, ajo nuk është ekzistencë, nuk është materie, por është gnoseologji, ose ontologji, pra mundësia ose pamundësia objektive dhe subjektive e njohjes së një realiteti, për të cilin ende nuk e dimë nëse është krejtësisht objektiv ose krejtësisht subjektiv. Ndonëse është zhvilluar paralelisht me vetë prodhimin letrar themelor, primar, kritika letrare ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe sot një synim i lexuesit të specializuar për të depërtuar në të fshehtat e dukshme dhe të padukshme të një veprë letrare themelore. Në letërsinë shqipe kritika letrare fillon të zhvillohet pasi prodhimi primar letrar arrin një shkallë zhvillimi, merr trajtë dhe specializohet shumë më vonë, për të kaluar nëpër dy fenomene, deri diku paradoksale: fenomeni i parë ka të bëjë me periudhën kur kritika letrare shqipe, veçmas pjesa e saj që u zhvillua në Kosovë, krijon ose vetëkrijon idenë se është më e rëndësishme dhe më e zhvilluar se vetë produkti letrar themelor, pra se vetë letërsia; fenomeni i dytë ka të bëjë me idenë se kritika letrare është e pavarur, madje se është oponente e letërsisë dhe e lexuesit, dhe se ndaj krijimtarisë themelore letrare, sikundër edhe ndaj lexuesit, mund të sillen pa asnjë konsideratë. Mendoj se këto dy situata paradoksale e kanë çuar kritikën tonë letrare në një rrugë pa krye, kur ajo realisht e ka humbur funksionin e saj. Kritika letrare tani mungon, sepse ajo tashmë nuk ka funksion, nuk i shërben një qëllimi, nuk i shërben askujt, as lexuesit, as veprës letrare, as autorit të shkrimit letrar themelor, vetëm atyre që e shkruajnë atë.

Fenomeni i parë, fenomeni i mbivlerësimit të vetvetes, me kritikën tonë letrare ndodhi nga mesi i viteve shtatëdhjetë dhe më vonë, kur studimet tona për letërsinë vunë kontaktet e para me shkollat moderne letrare, të cilat bënë analiza të thelluara

të tekstit, duke anashkaluar metodat tashmë të vjetruara sociologjike, historike, biografike etj., të analizës së veprave letrare. Përveç dijes letrare dhe njohjes së fenomenit krijues, depërtimet e thella në përbërësit strukturorë të tekstit letrar kërkonin edhe njohje të procesit krijues, sikundër kërkonin nga kritiku dhe studiuesi i letërsisë të ishte edhe ai kreativ dhe të kishte imagjinatë, ndryshe nga kritikët e deriatëhershëm që i referoheshin më shumë dijes skollastike. Shumica e kritikëve tanë të gjeneratës së re i përvetësuan këto metoda të analizës dhe të studimit të veprës letrare, kështu që Barti, Sosyri, më vonë Todorovi, Zheneti etj., përveçse zëvendësuan në të gjitha pikat Sent-Bevin, Bjelinskin apo edhe Lukaçin, u bënë emra “familjarë”, të përdorshëm dhe të përshtatshëm për çdo rrethanë. Nuk do mend se kësaj kritike të avancuar, ndër punët e para që bëri, iu desh të krijonte *letërsinë e saj*, veprat e saj dhe autorët e saj, të tillë që do të ishin kuadër i mjaftueshëm për marrjet e saj joselektive. Nëse nuk do ta gjente një letërsi, një autor dhe një vepër të tillë, ajo do ta shpikte atë me çdo kusht. Në këtë mënyrë, në vitet shtatëdhjetë dhe prapa, në letërsinë e Kosovës kritika krijoi autorët e saj, të cilët ishin të papërdorshëm për lexuesin me nivel të tillë kulturor që mezi absorbonte letërsinë e realizmit socialist të Shqipërisë, në një kohë që media e shkruar dhe botimet gëlonin nga autorët që nuk i lexonte askush dhe nuk kishin asnjë funksion në jetën kulturore të këtij ambienti. Megjithatë, kjo rrethanë i ndihmoi kritikës sonë që të vendoset mbi letërsinë themelore dhe të bëhet, në njëfarë mënyre, sundues dhe zot i saj, të bëhet arrogante, imponuese dhe të sillen pa konsideratë ndaj krijimtarisë letrare.

Situata do të bëhet e pashpresë vitet e fundit, kur numri i studiuesve të letërsisë të shtohet në mënyrë joproporcionale me krijimtarinë themelore letrare. Aktualisht, ne themi se nuk kemi kritikë letrare funksionale, ose themi se nuk e kemi të mjaftueshme, një e tillë kritikë, e cila do të ndiqte zhvillimet letrare aktuale dhe do t'i shërbente letërsisë dhe lexuesit. Por, në anën tjetër, kemi një shtim të pakontrolluar të të ashtuquajturve studiues të letërsisë dhe shtim rapid të teksteve që mbajnë në agjendë disa autorë të viteve shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë, që mbajnë në agjendë

shkollat e studimeve letrare botërore të po kësaj periudhe, në një kohë që letërsia shqipe dhe letërsia kontemporane kanë njohur zhvillime krejtësisht të reja, më të avancuara se tekstet kritike të shumicës së studiuesve. Në studimet kontemporane për letërsinë, në anën tjetër, kemi një kthim pothuajse të përnjëhershëm nga *fenomenologjia*, si një përfshirje komplekse të të gjithë përbërësve të fenomenit letrar, ku analiza tekstore, në të cilën janë barrikaduar studiuesit tanë të letërsisë, është vetëm një komponent, i rëndësishëm gjithsesi, por jo i vetëm. Pra, në këtë pikë, sado që përpiqet të duket e avancuar, kritika letrare te ne vitet e fundit ka shënuar ngecje dhe rënie.

Por paradoksi më i madh qëndron në faktin se tani, së fundi, në Kosovë nuk kemi pothuajse asnjë libër proze në vit që të botohet, nuk kemi asnjë libër dramash, gjithnjë e më rrallë kemi ndonjë libër të shënuar poezish, ndërkohë që kemi nga disa libra në vit studimesh letrare, që nuk i shërbejnë as letërsisë as lexuesit, por iu shërbejnë *përfituesve të letërsisë*. Kjo lloj supremacie, të cilën e kanë krijuar studimet letrare dhe kritika letrare mbi letërsinë themelore, nuk është e natyrshme dhe është e predispozuar të dështojë. Pra, si përfundim, dilema e kahershme nëse kritika letrare është krijimtari themelore letrare, apo është vetëm përfituese e saj, mbetet ende, sikundër edhe dilema tjetër, se cili është funksioni i kritikës, a duhet ajo t'i shërbejë letërsisë dhe lexuesit, apo as njërës as tjetrit, por është lloji i krijimtarisë që funksionon për veten e saj. Nëse kritika nuk ka një funksion utilitar dhe është pjesë e krijimtarisë imagjinatave, ose e konsideron veten si të tillë, ajo duhet të heqë dorë nga imponimi. Ajo nuk mund t'i imponojë askujt asgjë, as vlerësim, as sugjerim, as vullnet, as dije, as rregulla, as kode, pra asgjë. Ajo duhet të tërheqë lexuesin e saj jo duke “shfryrë nepsin” mbi letërsinë themelore, por duke e joshur atë me depërtime të thella, qofshin edhe imagjinatave, në shtresimet kuptimore të veprës së letërsisë themelore. Së këndejmi, kritika letrare te ne duhet të pushojë të sillen si padrone e letërsisë, ose si oponente e saj...

(Fjalë e mbajtur në tribunën për kritikën letrare, në kuadër të takimeve letrare “Azem Shkreli”, më 23 maj 2012, në Pejë)



PËR HERË TË PARË DOSJA E OPERAS "SKËNDERBEU"

Nga ZHANI CIKO

Është shumë e rëndësishme të vëmë në pah se në një epokë si ajo e “Rinascimento-s dhe Barock-ut” europian, në të cilën modeli i heroit evokohej më tepër i marrë nga antikiteti, ose nga kohë tepër të hershme, personazhi i Skënderbeut (Scanderbeg) mund të konsiderohej gati bashkëkohor me poetët Marlow e Spenser (në fund të pesëqindëshit), Sarrochi dhe Montalvan (në vitet ’600) ose me muzikantët Vivaldi, Francoeur e Rebel (në vitet ’700), të gjithë autorë të veprave më të njohura dedikuar princit shqiptar. Kjo vazhdimësi e trajtimit justifikohet edhe nga fama e fituar që në jetëgjallje me emrin e Giorgio Castriota Scanderbeg në kontekstin e Europës së kohës që ndeshet ende, herë me luftë e herë me paqe, me qytetërimin otoman.

Vivaldi (materiali i dërguar – Rikthimi i Skënderbeut në trojet e veta)

Shqiptarët, nga ana tjetër, nuk kishin më asnjë mundësi t’i këndonin publikisht heroit të tyre nën thundrën e okupimit të gjatë shekullor dhe kulturalisht letargjik e asgjësues për gati 500 vjet, ndërkohë që në qendrat urbane ishte imponuar muzika e ashtuquajtur **mehter** (që nënkupton muzikën e prodhuar nga bandat ushtarake të jeniçerëve) dhe **aheng** (që nënkupton muzikën e krijuar nga sistemi i mekameve – perdevë orientale).

Vetëm përmes traditës folklorike të artit gojor dhe rural, veçanërisht në zonat më pak të shkelura, u kënduan, së pari në intimitetin e përkundjes së djepit, “ninullat” me urime për rritjen e fëmijës si riprodhim i modelit të Skënderbeut. Po kështu, kujtimi i kryetrimin në riprodhimin e gjallë në “Këngët e trimërisë” – si kategori e etnosit muzikor – dhe sidomos në rapsoditë e kreshnikëve që përmes ostinatos së përmbajtur në lëvizje melodike, shoqëronin me lahutë, veglën e hershme mono-kordale, bëmat heroike të idhullit historik të Arbrit të robëruar.

Është pikërisht ky shoqërim i përzgjedhur i lahutës, i përdorur për të mos rënduar linjën tregimtare të rapsodit, dëgjimin e pastër të fjalës që të mos prevalon mbi muzikën dhe kërkon muzikën si evidentuese të theksimit logjik të vargjeve të gjata rapsodike, që krijimtarinë e përdornin si memorizim të përmbajtjes dhe transmetues gojor të mjetit më efikas, në kushtet e ruajtjes së mosekzistencës së librit dhe të censurimit të kujtesës, mundësisht zbardhjen e trurit dhe asimilimit përkatës.

Për konsekuencë, miti i Skënderbeut u rimor në kujtesën epike muzikore në fillimin e kategorisë së re të këngëve heroike patriotike, që u shfaqën në fillim të viteve ’900, nën ndikimin e Lidhjes së Prizrenit, të

tilla, si “O trima luftëtarë, O bijtë e Skënderbeut”, krijim i gazetarit dhe muziktarit patriot Thanas Floqi (1939-1945), ku ndihet modeli i ndërthurur mbi ritmikën asimetrike popullore të 7/8, model i përdorur gjerësisht në folklorin tonë.

Është vendi të theksojmë se kënga patriotike që sapo lindi, vargun patriotik e skeletizoi mbi ritmikën autentike tonën. Po kështu Mihal Ciko, i pari këngëtar lirik i plejadës së artistëve tanë, solli këngën “Shpatari i Skënderbeut”, për solo dhe grup koral, botuar në të hershmen këngëtore (1924) të Dhori Kotit, që i jep atij autorësinë. Pas këtyre vijmë te drama muzikore të sferës skënderbeiane, “Rrethimi i Shkodrës”, “Ruba e kuqe”, të kompozuar nga kleriku Mikel Koliqi, kardinali i parë shqiptar, me libretin e Ndre Zadejës.

Dy veprat skenike, “Rrethimi i Shkodrës” dhe “Ruba e kuqe”, mbetën gjallë falë kurajës civile të kompozitorit Tonin Harapi, i cili në momentin e arrestimit të Dom Mikelit i mori ato fshehtas për t’i nxjerrë në dritë pas vitit 1990, kur nipi i autorit, Gjon Simoni, i kuroi dhe plotësoi për kor dhe orkestër. Veprat, më në fund, u ekzekutuan nga Orkestra Simfonike e Radio Televizionit (dirigjent Alqi Lepuri) dhe më pas disa herë nga trupa e TKOB-së nën drejtimin e shkruarit të këtyre radhëve. Kardinali Mikel Koliqi pati kështu rastin t’i shikojë në video-regjistrim 2 veprat e veta, duke u siguruar se ato, si dhe emri i tij, do të vijonin në përjetësi rrugën e tyre të mundimshme.

Vepra e Martin Gjokës “Dy lule mbi varr të Skënderbeut” (1919) u soll në publik nga dirigjenti Eno Koço, i interesuar edhe për vepra të tjera të epokës në fjalë.

Autorë të tjerë të momentit, iniciues të muzikës kulte në vitet prevalente të përmbajtjes patriotike, si Palok Kurti (1892-1962), Thoma Nassi (1892-1962) si dhe Frano Ndoja me një *Fantazi për Skënderbeun*, pasuruan repertorin e Orkestrës me vepra që zgjerojnë dhe plotësojnë atmosferën, në mos direkt për Heroin, së paku për frymën që ato përçuan.

“Skënderbeu” (1937) ishte jo vetëm vepra e parë simfonike e Fan S. Nolit, sigurisht dhe më e shtjelluara profesionalisht, jo vetëm për ato vite, por edhe interesante në konceptin dhe shtjellimin muzikor edhe për sot.

Imzot Noli, muzikant i hershëm, por i kompletuar vonë si kompozitor i shkolluar, për më tepër historian dhe poet direkt me vepra të mirënjohura dhe referues në të gjithë lëmenjtë e lëvruar për Heroin tonë, për çudi Poema Simfonike Omonime e gjeti inspirimin jo në Skënderbeun poetik apo në atë historik të vetë Nolit, por në një vepër të tjetërkujt, në poemthin e Henry Longfellow-t.

Me ndodhjen time, nga viti 1968, si orkestrant dhe në drejtimin artistik të institucionit të TOB-së nga viti 1970, më kujtohet që erdhi një kuti postare nga “Vatra” e Bostonit, me veprën në fjalë (Skënderbeu), “Rapsodi shqiptare” dhe “Gaspari i vorfën”, poemë vokale për tenor dhe orkestër me poezi të Paul Verlein. *Uverturën Bizantine* e njohëm më vonë, pasi në vitin 1970 as bijve amerikanë nuk u erdhi mbarë ta dërgonin në vendin që kishte shpallur prohibicionin e besimit me gjithë ç’kishte me vete.

“Skënderbeu” kishte mbërritur në Tiranë, siç e thamë, në vitin 1968 dhe e gjeta në zyrën time të parë në TOB më 1970. Asgjë nuk ndodhi, përveç leximit personalisht të veprës, manuskript, shkruar pastër dhe me kujdes për të mos lënë dyshim për asnjë notë. Kishim të bënim me një vepër me program të përbërë nga disa fragmente në vijim të njëri-tjetrit:

1. Tema e Skënderbeut
2. Thirrja e Muezinit, në mod frigjian
3. Vallëzimi oriental dhe fugë vijuese
4. Kënga shqiptare për Skënderbeun në mod bizantin me sekondë të zmadhuar
5. Përpunimi i korales të Bach-ut (nga pasionet sipas Sh. Matheut) “O Hampt voll Blut und Wunden” (O Zot për gjak dhe plagë – përkth. im)
6. Hymni i Kryqëtarit
7. Rendja e kalorësit dhe dy këngë folklorike shqiptare
8. Dy himne bizantine për pashkët

Vepra dallohet për thellësinë e gjuhës muzikore, trajtimin me koshiencë nga autori në modalitete arkaike dhe evokime të sistemeve polifonike vokale, labe dhe toske, të cilat ndeshen në kontrapunktin bahian, jashtë çdo simfonizmi efektuoze e rutinor. Ajo mbetet ende jo vetëm një pikë referimi, por dhe interpretimi më të thelluar.

Partet e Orkestrës u kopjuan me dorë, siç ndodhte atëherë për çdo vepër, nga kopistët e zellshëm të Operës. Siç duket, drejtori i atëhershëm Koço Vasili, biri i njërit nga instrumentistët e riatdhesuar të bandës “Vatra”, bëri njoftimet përkatëse. Përsëri heshtje...

Mbase afrimi i 100-vjetorit të lindjes së Nolit, më 6.1.1972, bëri që disa muaj më parë, një funksionar i lartë i qeverisë së kohës, të kërkonte një dëgjim të veprës në sallën e provave të Orkestrës.

Aty, për herë të parë, dëgjua “Skënderbeun” nolian, drejtuar nga mjeshtri Rifat Teqja. Dëgjimi u mbyll në heshtje dhe pa asnjë koment.

Kuptova se “Skënderbeu” do të priste ende, mbase për kohë më të mirë...

“Skënderbeu” priti, por jo Noli.

Me iniciativën e postit që mbaja, më 11 janar (atëherë festa e Republikës) organizuam koncertin

e parë të orkestrës së bashkuar TOB, në RTSH, që e quajtmë “Filarmonia e Tiranës” ku, ndër të tjera, ekzekutuam premierën në atdhe të “Gaspari i vorfën”, baladë për tenor dhe orkestër mbi poemën e Paul Verlein, kënduar nga artisti i popullit Gaqo Çako, dirigjent Emir Krantja. Në mos rikthimi historik i Gjergj Kastriotit në Krujë (1443), ishte kthimi i Nolit më 1972 si kompozitor, në skenën më të rëndësishme të Shqipërisë.

Politikisht kisha realizuar ngjitjen për herë të parë në skenë të një autori dhe veprë muzikore, jo të “realizmit socialist”, që përdorej jo gjithmonë me të drejtë atëherë.

Me orkestrën e RTSH-së rreth viteve '90, gjatë drejtimit tim të sektorit muzikor në RTSH, u ekzekutuan të gjitha veprat orkestrale të Nolit, “Skënderbeu”, “Rapsodi shqiptare” dhe madje edhe “Uvertura bizantine”, në mbremje të ndryshme, nën drejtimin e dirigjentit Eno Koço.

Me orkestrën e TOB-së, “Skënderbeu” u programua dhe u ekzekutua në koncertin jubilar të 650-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe 90-vjetorit të pavarësisë, në Pallatin e Kongreseve, drejtuar nga prof. Alqi Lepuri (28.11.2015).

Pas një njohjeje të gjatë dhe përpjekjeve për vlerësimin e krijimtarisë muzikore noline, më 2012, me orkestrën e TKOB-së realizova drejtimin personalisht të “Skënderbeut”, në mbremjen “Penda e muziktarëve të hershëm shqiptarë”, duke ndier përgjegjësisë e madhe të interpretimit të një partiture muzikore, ku mençuria, kultura dhe frymëzimi është më lart se akti muzikor i një savanti dedikuar me gjithë ç'mundi kombit të vet.

Vitet e regjimit, pas Luftës së Dytë Botërore, shënuan ecuri përpara për praktikën profesioniste të muzikës sonë të kultivuar, çeljen e institucioneve të larta dhe shkollave të specializuara për artet. Me kalimin e kohës filluan të aplikohen “kanone” estetike dhe më pas politike, që ndikuan në rezultatet e prurjeve artistike, por dhe ndrydhjen e afrimit në plan të gjerë të autorëve dhe veprave të tyre, me hapësirën europiane e më gjerë.

Trajtimi i repertorëve tematikë, edhe pse krijimtaria kombëtare zotëroi për disa dekada tërësisht jetën muzikore, mbeti në vartësi të eventeve jubilarë e partitëse që kontrollonin imtësisht çdo partiturë të re, nga kënga te veprat madhore. Kështu, në tematikën skenike muzikore u ndalua që në fillim baleti “Teuta” i Nikolla Zoraqit, sipas libretit të Zef Zorbës, nga e cila mbeti vetëm “Uvertura në Faminor”, e ekzekutuar dhe pritur shumë mirë (sot e zhdukur si partiturë).

Po kështu dhe Opera e të njëjtit autor, sipas tregimit të njohur të Dhimitër Shuteriqit “Ditët e sprapsme të Gjergj Golemit”, me libret të dramaturgut Kol Jakova, pas përfundimit të veprës, nuk pa dritën e skenës (edhe sot ende) për shkak të personazhit historik, murgut Nikodim, që mbyll me sakrificën e tij fundin e Operës.

Është i njohur suksesi i muzikës së filmit “Skënderbeu”, me autorë sovjetikun Georgi Sviridor dhe kompozitorin tonë të shquar Çesk Zadeja, ku krahas temës (a lajtmotivit) “Qenkan mbushur malet me borë” të At Martin Gjokës, ka zënë vend dhe romanca tepër e vlerësuar “OH! Ju male” e Zadejës. Më vonë Zadeja e sistemoi prurjen e vet në suitën omonime nga muzika e filmit.

Viti 1968, si viti jubilar i heroit (500-vjetori i vdekjes), solli krahas operës “Bijt e Skënderbeut” të kompozitorit Abdulla Gërmei me libret të Matish Gjellucit, shfaqur nga artistët amatorë të Pallatit të Kulturës “A. Moisiu”, Durrës – regjisor Artisti i Popullit, Kristaq Antoniu, dirigjent Ermir Dizdari.

Pjesë e festimeve të Jubileut ishte dhe opera “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu”, me muzikë të Artistit të Popullit Prenk Jakova dhe libret të poetit Llazar Siliqit, regjisor Pirro Mani dhe dirigjent Mustafa Krantja, njëherësh dhe udhëheqës artistik i institucionit.

Për një rastësi, unë fillova punën si violinist i parë në këtë institucion, me realizimin e kësaj veprë madhore. Duke qenë se në atë kohë ishte në praktikën e institucioneve që, krahas emrave më të spikatur, në këshillin artistik zgjidheshin edhe 1-2 të rinj, ishte rasti që të bëja pjesë edhe unë.

E njoha muzikën e Operës, në themel dhe në çdo notë, – ishte përvoja ime e parë me një part krejtësisht të ri, në pultin e parë ku udhëhiqte violinisti Islam Petrela, i njohur shumë mirë dhe i respektuar prej meje. Opera kishte një “kast” artistësh, më të mirët e mundshëm, me Skënderbe artistin e veçantë Gjoni Athanas, i denjë për figurën e rolit, dhe interpretimin muzikor aktorial. Opera ishte shkruar enkas për Gjonin. Zgjedhja e autorëve ishte e drejtë.

Por shpejt u ndodha në zjarrin e betejës artistike më të egër dhe të paimaginueshme për mua. Mbledhjet e Këshillit Artistik bëheshin shumë shpesh në sallën e korit të Ansambllit dhe korit të Operës. Autorët dëgjonin fillimisht vërejtjet e drejtorit që përpiquej të qëndronte mes palëve, anëtarëve të komisionit dhe kompozitorëve të tjerë të jashtëm. “Nganjëherë më pyesnin dhe mua që përpiquesha të mos ngatërroja më shumë situatën. Kur mendoj Prenkën e madh si “shtatore” përballë dikujt që ai e kishte mësuar fillimisht, - shkruan Llazari, që përpiquej të gjente zgjidhje sidomos për vërejtjet ideore dhe të tjerë që ishin njëherësh më të gjitha krahët, - ende shqetësohem dhe më vjen zor që isha aty”. Jo se s’kishte edhe mendime pozitive, por në tërësi mohohej e drejta krijuese dhe lira e zgjedhjes autoriale. Mbaj mend se u paraqitën katër variante të libretit. Lufta ishte mes variantit të parë dhe variantit të dytë. Më pas libreti u afrua (variant i tretë).

Figurat shqetësuese ishin murgu Gjon, që më pas u bë shoku i Kastriotit, Gjon Flamura, pozicionet e princave, koralet, skenat e turqve, e me radhë...

Partet në orkestër dhe partiturat e dirigjentit, mbas çdo mbledhje të K. A, spostoreshin dhe, më në fund, me vështirësi u bënë të rrjedhshme. P.sh., në një variant Opera hapej me murgun Gjon që shkruante kronikën e ankthit të pritjes së një ngjarjeje që ëndërronte të vinte (kthimi i Skënderbeut). Në një tjetër variant, aria e Donikës me fëmijët spostohej në aktin e tretë që më pas u zhdukën si akte dhe mbetën vetëm dy pjesë (me tri tablo secila). Ditët e fundit u shtua dhe një tablo, skenë baleti, për të cilën një kompozitor ofroi muzikën e valleve të tij. E kështu me radhë, gjë që më krijoi qysh atëherë dyshime se mos zvarritej qëllimisht. Pyesja veten: Nuk ka mundësi që “udhëheqja” që ka miratuar krijimin e veprës dhe madje ditën e premierës, të pengojë realizimin e saj. Atëherë? Mos vallë dikush a disa që

ndiejnë sfidën e autorit autodidakt, apo mos është si miti i legjendës: Mozarti dhe Salieri në operën e Rimskij Korsakovit?!

U çua në atë pikë, saqë rrezikohej premiera. Erdhi vendimi drastik i autorit: “Nuk e realizoj brenda afatit orkestrimin e veprës.” U vendos ndarja e saj (krahas vetë Prenkës në skenat e fillimit) te dirigjenti Krantja, kompozitorët Tonin Harapi, Tish Daija dhe Çesk Zadeja, krijues të njohur dhe nxënës të Jakovës.

Nga dita ime e parë në Orkestër (1967) dhe më pas në rikthimin e Skënderbeut në skenë më 2012, si drejtor i përgjithshëm dhe dirigjent i Operës, u binda se zgjuarsia e autorëve dhe strategjia e përballjes me kundërshtarët ishte ajo që ata nuk eliminuan asnjë material muzikor, asnjë skenë, arie apo korale. I ruajtën të gjitha dhe vetëm i spostonin si në një tabelë shahu, aty ku nuk dëmtohej asgjë.

Veç partiturës, kam studiuar nga fillimi të gjitha variantet e libreteve ku ka tekste të shkurtuara dhe të spostuara, por nuk ka asnjë notë të lënë jashtë partiturës. “Dosja e Skënderbeut” në familjen Jakova dhe Siliqi ruan dokumentet e së vërtetës.

Autorët ishin shqetësuar dhe dëshpëruar shumë, gjë që ma kanë konfirmuar në koefidencë, në një takim miqësor në Kafënë e Madhe, në Shkodër, një vit më vonë. Mbas pak ndodhi ajo që dihet tashmë, diskreditimi në shtypin partiak dhe tragjedia e autorit, kryelartit Prenk Jakova, sot Nderi i Kombit.

U përpoqa në rivënieën e vitit 2012, në pozitën e drejtorit dhe dirigjentit të veprës, të kuptoj synimet e autorëve dhe i respektoj ato në premierën e dytë të veprës. Së pari, trajtimi i heroit të ishte pozicionimi i tij si princ i Arbrit dhe jo si prijës i një popullate, kryesisht baritore.

Prej kësaj derivuan dhe shumë zgjidhje skenike, regjisoriale apo dekorative e të kostumografisë, detaje të portretizimit muzikor të Heroit etj.

Finalja e Operës që, për shkak të rrethanave, në variantin e vitit 1968 ishte më e varfër se e pjesës së parë, u plotësua pa shtuar asnjë notë në muzikë përmes mjeteve të tjera skenike.

Shfaqjet në Tiranë ishin dinjitoze, ndërsa shfaqja në Operën e Shkupit ishte triumfi artistik dhe kombëtar i saj. Desha të them diçka vetjake si analizë tepër e ndier për veprën, por më duket e vogël përballë artistëve që sakrifkuan, mundimit dhe madhështisë së autorëve.

Vepra të reja pasurojnë repertorin skënderbeian, sidomos në çdo jubile.

Kjo do të ndodhë natyrshëm. Vetëm atë që koha do ta vlerësojë të denjë, do të çelë portën e kështjellës që ruan, krahas historisë, edhe vlerat e vërteta e të qëndrueshme të artit.



Kjo ligjëratë është mbajtur më 18 mars 2010, ditën e hapjes së Panairit të Librit të Lajpcigut në Gjermani. Shkrimtari i njohur bullgar Georgi Gospodinov ishte ndër gjashtë shkrimtarët evropianë, që qenë ftuar prej organizatorëve të këtij panairi në programin “Autorenspecial” për të folur mbi temën Krizë! Çfarë krize? Është fjala për rolin e letërsisë kundrejt ekonomisë dhe krizës së sotme financiare. Botohet me pak shkurtime.

GEORGI GOSPODINOV: ROLI I LETËRSISË KUNDREJT EKONOMISË DHE KRIZËS SË SOTME FINANCIARE.



Zonja e Zotërinj,

Kërkoj të mbrohem si i pafajshëm qysh në fillim. Jam ftuar këtu për të folur si shkrimtar për një krizë që nuk e kam nxitur unë. As unë, as gjithë raca e shkrimtarëve, as njerëzit e këtij panairi, lexues e botues bashkë. Në rastin klasik, shkrimtarët dhe paraja janë dy institucione, të dënuar për të patur marrëdhënie goxhë të ftohta. Përsëritet, por nuk flasim me njëri-tjetrin, nëse perifrashojmë përgjigjen që dha Volteri, kur e pyetën për marrëdhëniet e tij me një instancë tjetër shumë më të lartë. Edhe këtu më duhet të pranoj, se më mungon përvoja në këtë fushë kaq të rëndësishme. Asnjëherë nuk kam marrë kredi nëpër banka; së pari, sepse u trembam këtyre institucioneve, dhe, së dyti, asnjë bankë, sikundër e dini, nuk do t’u japë kredi njerëzve me profesion të lirë e pak joserioz, si profesioni i shkrimtarit. Ja, pra, sesi njeriu mbetet i pafajshëm dhe i virgjër jo nga e mira.

Le të përfytyrojmë tani sikur në të njëjtën kohë, paralelisht me këtë panair libri, diku zhvillohet një forum ekonomik. Me temën Letërsia! Çfarë letërsie? Janë ftuar gjashtë ekspertë evropianë të financave për të mbajtur ligjëratë. Ekonomistë të shquar kanë mbushur sallën dhe presin të dëgjojnë sesi letërsia ndikon mbi gjendjen e tregut financiar, mbi kreditë e këqija, mbi krejt sistemin financiar, mbi dëshirat e klientëve për konsum etj. E di se është e vështirë të përfytyrohet, madje qesharake. Sepse e kemi një farë arsyeje të dyshojmë, që lojtarët e mëdhenj të fushës së financave nuk lexojnë shumë poezi e prozë. Nuk kemi parë bankierë, ekonomistë, financierë, sipërmarrës privatë, komisionerë të bursës, të kalojnë orë të tëra mbi faqe romanesh apo përmbledhjesh me poezi, të debatojnë fjala vjen për Çehovin, Xhojsin ose Tomas Manin. Diçka të tillë nuk na e ka zënë syri në asnjë nga filmat që kemi parë. Megjithatë, më duket se, sikur financierët të këndonin libra, krizat tona do të ishin më ndryshe.

Lypset të mos e mohojmë këtu, se ne, njerëzit e krahut të letërsisë, shkrimtarë, botues dhe lexues të flaktë, e kemi pranuar deri diku disfatën tonë. E kemi pranuar njëfarësoj kokeulur vendin e mënjanuar në cep. Politika dhe ekonomia janë ato që e bëjnë botën të vërtetë. Arti dhe letërsia, në veçanti, janë ato shtojca ekstra, pa të cilat gjithashtu nuk mund të bëjmë. Sidoqoftë, libri nuk është objekt më i rëndësishëm, më i dëshiruar e më i shpeshtë në reklama sesa telefonat e lëvizshëm ose aparatet plej stejshën. Jemi mësuar, gjithashtu, me faktin se gjërat serioze për njeriun thuhet në mbrëmje në emisionet e lajmeve prej njerëzish seriozë profesionesh serioze, ose prej rubrikave politike e ekonomike të gazetave. Kurse herët më të shpeshta të fundit, kur kam parë në faqet e para të gazetave të mëdha emra shkrimtarësh të mëdhenj, kanë qenë njoftime për vdekjen e tyre. Për ironi të fatit, “vdekja e autorit” vazhdon të jetë ngjarje, nganjëherë ngjarja e vetme letrare.

Është e qartë, se përfytyrimi utopik për forum ekonomik, ku të debatohet për letërsinë, hë për hë mbetet vetëm në imagjinatën time. (Po unë vazhdoj ta kem e ta mendoj.) ... Letërsia ka likuiditet të ngadaltë, me vështirësi shlyen edhe investimet më të vogla në vetvete. Nuk është e lidhur me tregun e burimeve energjitike. A keni parë që librat të tregtohen në bursat e mallrave? Pasi thamë këto, mbledhja e forumit të tyre mund të mbyllet, kurse letërsia të njihet si e panevojshme, sidomos në kohë krize...

Cilat janë arsyet dhe të drejtat tona për të folur për krizë financiare? A mos na akuzojnë se po hyjmë në mënyrë të paligjshme në livadh të huaj? E para, që dua të them, është se, herët a vonë, gjithçka bëhet objekt i letërsisë, çdo livadh hyn në letërsi. E dyta, e thënë fare shkurt, letërsia është më e hershme se paraja. Arsyet tona për të folur janë, në një shkallë të madhe, të karakterit historik. Këmbimi i fjalëve është më i hershëm se këmbimi i parasë. Duket sheshit, por ne shpesh jemi të verbër para gjërave që duken sheshit. Puna nuk qëndron madje as që letërsia ka për mjet gjuhën, e cila është ku e ku më e hershme se paraja. Më e rëndësishmja është, se vetë lindja e parasë, si shenjë, ndjek logjikën e thellë të gjuhës. Ashtu si fjala përmban objektin në vetvete, pa qenë ai i pranishëm realisht, ashtu edhe bankënota përmban objekte potenciale, me të cilat mund të këmbëhet. Përfytyronie çfarë do të ndodhte sikur të flisnim nëpërmjet vetë objekteve. Dua të them elefant, do të detyrohesh të sillja këtu elefantin. Po sikur të dua të them zjarr apo krizë?

Shkurt, e përfytyrueshmja, e cila është në themel të ekonomisë e të komunikimeve sot, historikisht buron nga përdorimet e gjuhës e të letërsisë. Nga konvencionet, me të cilat njeriu është mësuar në epoka të hershme. Letërsia dhe ekonomia mund të dalin të lidhura më fort se ç’ kemi pandehur. Një nga çështjet, që, për mendimin tim, endet në hapësirën e krizës së sotme financiare, është nëse virtualja ka arritur masën e vet kritike apo jo. Ka mundësi që shenjat t’i kenë tejkaluar objektet e shenjuara prej tyre, e të këmbëjmë shenja pa qenë të mbuluara me objekte. Le të ndërhyjë këtu semiotika. Kriza e sotme financiare është në një shkallë të madhe krizë e virtualitetit. Virtualiteti, që ka vajtur në cakun e vet të fundit, nuk është i garantuar me realitet të mjaftueshëm. Ashtu sikundër nuk kanë garanci të mjaftueshme kreditë.

Zonja e Zotërinj,

Vij nga një vend, që e ka njohur mirë shijen e krizave. I ka provuar dhe, për më tepër, pothuaj nuk ka dalë prej tyre gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit. Këto kriza morën hov pas fundit të komunizmit më 1989, por fara që hedhur, pati mbirë e rritur pikërisht gjatë dhjetëvjeçarëve të sistemit të mëparshëm. Isha 21 vjeç më 1989 dhe më kujtohen mirë dy gjendjet e krizës – ajo e kohës së socializmit, e mbuluar keqazi me

jorganin e grisur të ideologjisë, dhe ajo e tranzicionit pas rënies së Murit të Berlinit, të cilën tashmë askush nuk mendohej ta mbulonte për ta fshehur. Lista ime e vogël e krizave zë e nis në vitet ’80. Le të saktësoj, se ato janë të lidhura me socializmin alë bullgar dhe me moshën time të rinisë asokohe – domethënë, qysh atëhere kemi dy kriza të hershme. Ja dhe lista:

Kriza energjitike. E quanim “regjim i rrymës elektrike”. Tri orë me rrymë, tri orë pa rrymë. Disa bënin shaka, duke thënë se, po të vështrohej nga kozmosi, Bullgaria ngjante me një diskotekë. Të gjithë mbanim rezerva qirinjsh; rrinim ndenjor në dhomat e ftohta dhe qirinj të lëshonin hije mesjetare në muret e apartamenteve tona parafabrikate të shek. XX.

Kriza e mallrave të nevojës së parë. Në periudha të ndryshme kohe zhdukeshin mallrat më të domosdoshëm. Në vitet ’80 kryet e vendit e zin mungesa e vajit, e peceve për femra, e letrës së tualetit, e piperit të zi, për të mos folur për banane e portokaj, të cilët dilnin vetëm për Vit të Ri. Nxirrnin portokaj në treg, domethënë kishte ardhur Viti i Ri. Na u bë refleks, si ai i qenit të Pavlovit. Portokaj sidoqoftë provoja, por gjatë gjithë fëmijësisë sime nuk arrita të shkoj deri te vezët prej çokollate e te çokollata e vërtetë Milka, aq shumë të para në ëndërr. Gjendeshin vetëm nëpër të ashtuquajturat korekome – dyqane ku mund të bleje vetëm me valutë; mirëpo, për valutë, duhet të kishe status special. Prandaj, puna e parë që bëra pas rënies së socializmit, ishte blerja e vezës prej çokollate. Ishte viti 1990, gjendeshin nëpër dyqanet e zakonshme, mbledha paratë e duhura. Më kujtohet mirë sa i emocionuar isha kur pagova te arka dhe, nuk e di përse, i mërmërita shitëses se e doja për një nipin tim. E rrëmbeva, hyra në dhomën time të konviktit studentor, u kyça përbrenda dhe zura ta ha mengadalë e me egocentrizëm vetëm për vete, shumë mengadalë, për të gjithë ata vite që e kisha pasë ëndërruar. Isha 22 vjeç. Nuk kam si ta harroj atë shije çokollate e lotësh. Sa mirë që nuk po më shihte kush. Ky qe muri im i Berlinit prej çokollate. Fundi i socializmit nganjëherë është edhe në gjëra të tilla të vockëla.

Mund të vazhdoj edhe me shumë mikrokriza vendore të viteve ’80, ndër to edhe me gjithë atë terr informativ (ta quajmë krizë e informimit) mbas avarisë në centralin elektrik bërthamor të Çernobilit...

Para pak kohe shkrova një skenar për një film metrazhi të shkurtër prej 4 minutash për këtë vit të superkrizës bullgare, për 1996-ën. Ky film rrëfen historinë e një nëne, e cila këmben disa dollarë për të blerë vezë, djathë, kërpudha e për t’i bërë omëletë të birit. Duke pritur në radhë, kursi i këmbimit ndryshon disa herë dhe, në fund, i mbeten parë vetëm për tri kokrra vezë, nga të cilat rrugës për në shtëpi i shpëtoi vetëm një. Omëleta me një vezë është mjaft e veçantë. Për ironi të fatit, ky film tërhoqi vëmendjen e Festivalit

të Filmit të Pavarur në Sundance, Amerikë, në fillim të vitit 2009, mu në kulmin e krizës së sotme.

Kjo është shkurt përvoja ime bullgare e krizave më parë. Çështja është: nëse ke jetuar në krizë të përhershme, si kjo e 30 viteve të fundit, si do ta ndjesh krizën e radhës, për të cilën po flasim sot. Për të patur ndjesinë e krizës, e cila është ndjesi higjenike, duhet të kesh qenë i pranishëm edhe në kohë tjetër, në kohë pa krizë. Është një brez i tërë (a thua vetëm një), që nuk ka jetuar jashtë kësaj situatë. Ky brez nuk ka kujtesë tjetër, ndjesi të tjera dhe përvojë tjetër. Si e percepton ai krizën e radhës? Si do të reagojë ndaj situatës nëpër të cilën ka kaluar kriza? A e di ai si jetohej në kohë normale? Më lejoni t'u jap disa shifra. Në vitin e fundit në Bullgari janë 100.000 të papunë të rinj, 50.000 prej të cilëve në moshë fare të re. Simbas Eurostatit, për kriterin “mungesa materiale” zemë vendin e parë në Bashkimin Evropian (51% e bullgarëve vuajnë mungesash materiale). Kurse ndjesia e përgjithshme ndër njerëzit është se kriza e vërtetë ende nuk ka mbërritur tek ne. Të paktën nuk ka ardhur e gjitha. Për mendimin tim, më e tmerrshme se ndjesia e krizës është mungesa e kësaj ndjesie, mungesa e shqisave për ta ndjerë krizën. Njëlloj sikur të mos kesh receptorë për nxehtësinë. Atëherë çdo sobë ose furnellë mund të të djegë. Ajo, me të cilën letërsia mund të ndihmojë, është në punë të zhvillimit të ndjeshmërisë ndaj krizave. Përndryshe, ato do të jenë të përhershme e të pandërprera, kurse pandjeshmëria jonë ndaj tyre – kronike.

Përsëri simbas të dhënave të Eurostatit, afro 17%, ose një në gjashtë vetë në BE, jeton në pragun e varfërisë. Pra, kemi një shtet të padukshëm evropian me 80 milion qytetarë brenda. Ky shtet nuk është i shënuar në hartë, por është me popullsi më të madhe se Franca, se Italia, Spanja, Polonia. Një shtet i varfërisë, i madh sa çështje Gjermania. A e njohim sa duhet? Por le t'i kthehemi Bullgarisë shumë më të vogël. Zyrtarisht kriza e tanishme mbërriti atje në korrik 2009. Domethënë ka bërë rreth dy vjet e gjysëm rrugë për të ardhur nga Amerika. Shpejtësia nuk ka qenë fort e lartë. Por dihet, se në këtë pjesë të Evropës edhe rrugët nuk janë aq të mira. E vërteta është se qeveria bullgare në atë kohë nuk prante ta shihte krizën. Ngulte këmbë se treguesit ekonomikë janë shumë të mirë dhe Bullgaria është “ishull i stabilitetit” në oqeanin e krizës botërore. Çka tani e dijmë me siguri, dhe kriza na e afirmon prapë, është se ideja e ishullit tashmë nuk vlen. Letërsia, natyrisht, e dinte para ekonomisë. Ata rreshta të bukur libri mbi pamundësinë për të qenë ishull e për

kambanat, që gjithmonë bien për ty, të John Donne-it – të gjithë i dijmë (falë edhe Hemingueit) – janë të vitit 1624. Dhe janë rreshta, që gjenden në një libër lutjesh e përsiatjesh, me titullin e bukur e të përshtatshëm për sot “Lutje për rastet e papritura”.


Dihet se kriza financiare mori udhë prej të ashtuquajturave kredi të këqija, të lëshuara shpejt e shpejt e me kollajllëk, pa qenë të siguruara me garancitë e nevojshme. Dihet se “kredi” vjen nga latinishtja “credo” – marr hua, por edhe besoj, kam mirëbesim te... Kështu, etimologjia na thotë, se para krizës së kredive është kriza e besimit. Sot kemi ngrirje të kredive, përkthejeni edhe si ngrirje të besimit, të mirëbesimit. Për analogji me këtë, ne gjendemi përballë një sistemi shpjegimesh e vlerash të nxituara, të kollajta e të cekëta. Tregu dhe mediat në shkallë të madhe i ushqejnë këto procese. Tregu kërkon të blesh në çast, pa u menduar fort gjatë. Njeriu autentik është njeriu konsumues, që blen në pazar, njeriu makut për gjithçka të botës jashtë tij. (*Greed is good*, sikundër thotë fraza e njohur e Gekko-s). Mos ngurro, thotë pazari, kjo është natyra jote. Dëshiro, merr parà me vete dhe shko e rrëmbe menjëherë atë që do. Jeto sot. Nga ana tjetër qëndron kultura, me të gjitha ngurrimet e luhatjet e veta. Dhe me idenë absolute jokomerciale si të jetohej nesër. Dy botë të ndryshme, në gjendje të nderë mes tyre. Është e qartë në cilën anë qëndron epërsia. Them se domethënia e letërsisë është të marrë anën e të humburve. Vlera për të qenë fitimtar e për të qenë i pacenueshëm, pra për të mos u prekur nga dëmet, është e natyrshme për sistemin e kapitalizmit. Por, për njerëzit që janë nga vendi ynë humbës, ia vlen të ndjekin cenueshmërinë si vlerë, ngurrimin për t'u menduar mirë dhe dyshimin. Unë besoj në njeriun që dyshon, ngurron e mendohet mirë. Cila është lidhja me mediet? Diku, Milan Kundera ato i quan “reduccioniste të mendimit”. Dashur pa dashur, ato transmetojnë shpjegime të kollajta për realitetin, madje shpesh marrin pjesë në përpunimin e tyre. Afërmendsh, edhe mediet vuajnë pasojat e krizës. Tkurrja e tregut mediatik, rënia e tirazheve dhe e kërkesave për reklama është fakt. Por strategjia e shpëtimit të tyre, të paktën në Bullgari, përfshin edhe një shkurtim e dobësim edhe më të thellë të brendisë. Të parat, që bien e hiqen nga gazetatat, janë faqet e analizave, të gazetarisë hetuese e zbuluese, të publicistikës e të rubrikave për librat e për kulturën. Këtë gjë e shoh mjaft jolargpamëse në rrafshin afatgjatë. Sepse, a nuk është e domosdoshme pikërisht në kohë krize të

ketë parashtrim më të madh versionesh për atë çka ndodh matanë asaj që shihet drejtpërdrejt prej fakteve? Ndër shpjegimet e kollajta për realitetin (kreditë e kollajta) do të shtoja edhe shpjegimin ekonomik, prej ekspertësh të ekonomisë. Kjo krizë është dështim për Homo Ekonomikusin fodull, sikundër është shkruar në disa analiza. Dështim për idenë se bota mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet marrëdhënieve ekonomike, rrjedhës së parave, tregjeve, përqindjeve të interesit, kredive. As depresionet ekonomike nuk mund të shpjegohen vetëm me parametra ekonomikë. Ne nuk jemi bërë vetëm prej ekonomie e politike. Jemi bërë edhe prej brengash e luhatjesh e ngurrimesh, prej gjërash të tilla të brishta e të pashpjegueshme. Çdo krizë ka anën e vet të dukshme e anën e vet të padukshme. Njërin mund ta masim, tjetrën – jo. Si mund të matet trishtimi, brenga, dhimbja? Çështja është të kemi shqisa ndijimi për të dyja anët. Dhe të mos orvatemi të shërojmë njërin me ilaçet e tjetrës. Sepse nuk ka sesi të shërohet pikëllimi e brenga me antibiotik. As depresioni yt vetjak me injeksion financiar. Ndodhemi para pragut, kjo është vetëm një nuhatje vetjake, të një krize të re, analoge me atë të shterimit të rezervave të naftës e të burimeve energjitike. Një herë e kam quajtur shterim të rezervave të ideve dhe synimeve të qarta. Po, në një shkallë të lartë kjo do të jetë një krizë globale, botërore. Mbase në vende të veçanta ajo do të ketë shprehje më të spikatur e më të rëndë. Atje ku rezervat e brendshme të ideve kurrë nuk kanë qenë vërtet të pasura. Dhe kanë firuar goxhà shpejt. Krizë e horizontit të ngushtë, krizë e motivimit, e së nesërme së paqartë, e luhatjes midis depresionit dhe agresionit, e hedhjes në erë të paqëtimeve dhe armëpushimeve tepër të brishta në shoqëri. Prandaj parashikoj një të ardhme të hatashme për letërsinë si gjeneruese idesh e synimesh të qarta. Diçka si burim energjetik alternativ. Çfarë bën letërsia, po ta themi në mënyrën më të thjeshtë. Rrëfen historira, e me këtë shtyn për më vonë fundin (Sheherezada), si dhe e zgjeron realitetin dhe kohën e trupin tonë vetjak të kufizuar. Jeta do të ishte dhimbshëm e shkurtër pa të. Çfarë tjetër? Na jep mjete për të interpretuar. Na mëson si ta mendojmë vetveten dhe botën përqark, si ta rrëfejmë, si ta këndojmë. Letërsia është medie e ngadaltë, ndryshe nga mediet klasike e të reja, por ideja, synimi e mendimi, që ajo jep, ka cilësinë e vyer të jetëgjatësisë.

Përktheu nga bullgarishtja:
Abdurrahim Myftiu



Çmimi
4500 lekë



Ferid Hudhri

SHQIPËRIA në ART